



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.107

2004

dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.9323
datë 25.11.2004

Për barnat dhe shërbimin farmaceutik.....

Faqe
7105

Ligj nr.9340
datë 23.12.2004

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për kontratën financiare për projektin e ndërtimit të TEC-it në Vlorë.....

7118

LIGJ
Nr.9323, datë 25.11.2004

PËR BARNAT DHE SHËRBIMIN FARMACEUTIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat për fabrikimin, importimin, eksportimin, tregtimin, përshkrimin, përdorimin, kontrollin e cilësisë dhe inspektimin e veprimtarive, që lidhen me barnat që përdoren për njerëzit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Fusha e veprimit

Këtij ligji i nënshtrohen të gjitha subjektet, personat juridikë e fizikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari të parashikuara në dispozitat e këtij ligji.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Barna" janë lëndë ose kombinim lëndësh me veti mjekuese e parandaluese të sëmundjes, si dhe për të vendosur një diagnozë mjekësore. Të njohura për veprimtarinë farmakologjike, imunologjike e metabolike, përdorimi i tyre në mënyra të përcaktuara mund t'i kthejë, korrigjojë ose modifikojë funksionet fiziologjike të organizmit të njeriut.

2. "Farmakopeja" është libri përmbledhës i standardeve dhe i normave, që me fuqi ligjore kushtëzon përgatitjen, kontrollin e cilësisë dhe ruajtjen e barnave me të rëndësishme, që përdoren në praktikën mjekësore.

3. "Lëndë medikamentoze", të njohura edhe si lëndë vepruese, janë lëndët me origjinë natyrore (minerare, bimore, shtazore), sintetike, të përftuara, nga proceset e fermentimit dhe teknologjia gjenetike, me synim të paracaktuar, për fabrikimin e produkteve farmaceutike si mbartës të veprimit farmakologjik.

4. "Efekt anësor" është përgjigjja e padëshirueshme ose e dëmshme e organizimit që ka përdorur një bar në doza normale për profilaksi, diagnostikimin, mjekimin e sëmundjes ose për të rikthyer, korrigjuar e modifikuar një funksion fiziologjik.

5. "Bar cilësor" vlerësohet ai bar që përmbush kërkesat e farmakopesë dhe të standardeve ekzistuese, duke garantuar njëkohësisht efektshmërinë dhe sigurinë, në përputhje me qëllimin e përdorimit të tij.

6. "Formë farmaceutike" kondiserohet bari i përgatitur, sipas disa proceseve teknologjike farmaceutike, në formën më të përshtatshme për t'u përdorur nga i sëmuri (tablet, ampulë, supost etj.) dhe për të ruajtur efektin veprues brenda afateve kohore të garancisë së deklaruar.

7. "Bar i gatshëm për përdorim" është bari që i nënshtrohet të gjitha proceseve të prodhimit, ambalazhimit dhe etiketimit përfundimtar.

8. "Fabrikim" është tërësia e veprimtarisë që përfshin blerjen e materialeve dhe lëndëve të para, prodhimin, kontrollin e cilësisë, ruajtjen, hedhjen në treg, shpërndarjen e produktit përfundimtar, si dhe të gjitha llojet e kontrollit të kësaj veprimtarie.

9. "Bar me origjinë bimore" është bari që ka përbërës veprues të vetëm një ose më shumë lëndë bimore, një ose më shumë përgatesa bimore, një ose më shumë lëndë bimore të tilla të kombinuara me një ose më shumë përgatesa bimore.

10. "Praktikë e mirë e fabrikimit" është ajo pjesë e sipërmarrjes për garantimin e cilësisë së shprehur edhe me inicialet GMP (Good Manufacturing Practice), që siguron se produktet farmaceutike gjatë procesit të fabrikimit janë kontrolluar vazhdimisht para nxjerrjes së tyre në treg, sipas standardeve cilësore në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre dhe kërkesat e certifikatës së regjistrimit.

11. "Garantim i cilësisë" është një koncept i gjerë, që shpreh tërësinë e masave të nevojshme për tejkalimin e problemeve që, veçmas ose bashkërisht, ndikojnë në cilësinë e produkteve farmaceutike, me objektiv sigurimin e standardeve në përputhje me përdorimin e tyre.

12. "Seri" është një sasi e caktuar e lëndës së parë, e materialit ambalazhues ose e produktit përfundimtar të prodhuar gjatë një procesi të vetëm ose disa proceseve në seri që siguron homogjenitetin e gjithë sasisë.

13. "Provë klinike" është një studim sistematik në njerëz për zbulime e verifikime terapeutike dhe/ose efektet anësore të produkteve mjekësore, si dhe për studimin e farmakokinetikës së tyre.

14. "Praktikë e mirë e ruajtjes" është tërësia e rregullave që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat që duhet të përmbushin mjediset ku ruhen lëndët e para, materialet ambalazhuese dhe produkti i gatshëm, në mënyrë që ndikimi i faktorëve fizikë (dritës, lagështisë e temperaturës) dhe i mikroorganizmave të jetë minimal për të garantuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e barnave, sipas farmakopesë dhe standardeve të miratuara.

15. "Agjenci farmaceutike" është njësi ku ruhen dhe tregtohen barnat me pakicë, në bazë të listës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

16. "Farmaci" është njësi tregtare-shëndetësore ku kryhen përgatitja, paketimi, kontrolli i cilësisë, shitja dhe ruajtja e barnave, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

17. "Formular farmaceutik" është manuali përmbledhës me autoritet ligjor i përgatesave farmaceutike më të zakonshme, të cilat mund të përgatiten në farmaci dhe të njihen si barna oficiale.

18. "Standard" është dokumenti ku përshkruhen normat e treguesve cilësorë, rregullat e marrjes së mostrës për analizë, metodat e analizave, rregullat e marketimit, të ambalazhimit, transportit dhe ruajtjes së barnave.

19. "Barna në shitje të lirë OTC" (nga anglishtja "over the counter"- "mbi banak") janë barnat që përdoren për vetëmjekim dhe shiten në farmaci pa recetën e mjekut.

20. "Certifikatë regjistrimi" është certifikata që jepet në çastin e regjistrimit të një bari, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

21. "QKKB" është Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave.

22. "KNB" është Komisioni i Nomenklaturës së Barnave.

23. "Importues farmaceutik" është njësi tregtare farmaceutike, që furnizohet nga fabrikuesit ose shpërndarësit farmaceutikë të huaj (të autorizuar nga fabrikuesi) për realizimin e importit të barnave.

24. "Eksportues farmaceutik" është njësi tregtare farmaceutike, që furnizohet nga fabrikuesit vendas dhe të huaj që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe realizojnë eksportin e barnave.

25. "Shpërndarës farmaceutik" është njësia tregtare farmaceutike, që furnizohet nga importuesit farmaceutikë dhe prodhimet e fabrikave që ushtrojnë veprimtarinë brenda vendit, për të realizuar shitjen me shumicë të barnave.

Neni 4

Ndalimi i veprimtarive dëmtuese të shëndetit

Ndalohet fabrikimi, tregtimi, importimi, eksportimi, përshkrimi dhe përdorimi i barnave që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, dëmtojnë dhe rrezikojnë shëndetin e njeriut.

Neni 5

Barnat veterinare

Prodhimi, importimi, eksportimi, tregtimi, kontrolli dhe përdorimi i barnave veterinare bëhen sipas legjislacionit në fuqi për veterinarinë.

KREU II

FABRIKIMI I BARNAVE

Neni 6

Praktikat e fabrikimit

1. Fabrikimi i barnave në Republikën e Shqipërisë bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, praktikat e mira të fabrikimit dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

2. Praktika e mirë e fabrikimit (GMP) miratohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe është e detyrueshme të zbatohet nga të gjithë fabrikuesit e barnave.

3. Fabrikuesve, që aktualisht ushtrojnë veprimtari, u lihet një afat prej dy vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për plotësimin e standardeve të GMP-së.

Neni 7

Licencimi

Personat juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari në fushën e fabrikimit të barnave, licencohen nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe marrëveshjet tregtare ndërkombëtare e rajonale të ratifikuara.

Neni 8

Fabrikimi në vend

1. Barnat mund të fabrikohen në vend nga personat juridikë, të licencuar vetëm pas marrjes së autorizimit përkatës nga Ministri i Shëndetësisë, sipas propozimit të Komisionit të Verifikimit të Kushteve të Fabrikimit të Barnave.

2. Fabrikimi i barnave për eksport u nënshtrohet të gjitha rregullave, ashtu si dhe barnat e fabrikuara me destinacion tregun shqiptar.

3. Komisioni i Verifikimit të Kushteve të Fabrikimit të Barnave ngrihet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe funksionon në përputhje me rregulloren e miratuar prej tij.

4. Ministri i Shëndetësisë miraton rregulloren, ku përcaktohen kushtet e fabrikimit, dokumentacioni i nevojshëm, standardet që duhen plotësuar, si dhe afati i dhënies së autorizimit për fabrikimin e barnave.

Neni 9

Ndryshimi i kushteve të fabrikimit

Ndryshimi i kushteve të fabrikimit bëhet me autorizimin përkatës të Ministrit të Shëndetësisë, sipas të njëjtave rregulla për autorizimin për fabrikim.

Neni 10

Barnat e përgatitura në farmaci

1. Për barnat e përgatitura në farmaci, sipas formularit farmaceutik dhe recetës së mjekut, nuk kërkohet autorizim i veçantë.

2. Formulari farmaceutik miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.

KREU III REGJISTRIMI

Neni 11

Qarkullimi i barnave

1. Barnat që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë duhet të jenë të regjistruara, me përjashtim të barnave të përgatitura në farmaci, sipas recetës së mjekut dhe formularit farmaceutik.

2. Për përballimin e gjendjeve emergjente (katastrofa natyrore, epidemi) ose në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (alternativa të vetme barnash për mjekim ambulator dhe spitalor), Ministri i Shëndetësisë autorizon importimin e barnave të paregjistruara, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

QKKB-ja dhe KNB-ja

1. Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB) është institucion i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike.

2. QKKB-ja funksionon me status të veçantë. Organizimi, struktura dhe mënyra e funksionimit të saj rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Komisioni i Nomenklaturës së Barnave (KNB) është organ këshillimor i Ministrit të Shëndetësisë. Përbërja, organizimi dhe mënyra e funksionimit të tij rregullohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 13

Aplikimi dhe praktika e regjistrimit

1. Aplikimi dhe praktika e regjistrimit të barnave bëhen nga mbajtësi i licencës edhe kur ky nuk është prodhuesi i barit në QKKB, sipas rregullores së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

2. QKKB-ja pranon për regjistrim vetëm barnat nga prodhues vendas, barnat e regjistruara dhe që qarkullojnë në një nga vendet e Bashkimit Europian, SHBA, Kanada, Japoni, Australi, si dhe në shtetet e Ballkanit Perëndimor të përfshira në marrëveshjet e ratifikuara për tregtinë e lirë.

3. Regjistrimi i barnave bëhet në QKKB, sipas rregullores së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

4. Barnat regjistrohen vetëm kur plotësojnë kriteret e efektshmërisë dhe të sigurisë, në përputhje me qëllimin e përdorimit.

Neni 14
Certifikata e regjistrimit

1. Ministri i Shëndetësisë, në bazë të propozimit të QKKB-së dhe KNB-së, urdhëron regjistrimin e barit.

2. Pas nxjerrjes së urdhrit të regjistrimit, QKKB-ja lëshon certifikatën përkatëse të regjistrimit mbasi të jetë bërë pagesa e tarifës përkatëse, jo më vonë se 2 muaj.

3. Certifikata e regjistrimit është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare, nga data e nxjerrjes së urdhrit të ministrit. Kjo periudhë mund të zgjatet nëpërmjet procedurës së regjistrimit pas paraqitjes së kërkesës.

Neni 15
Riregjistrimi

1. Bari reregjistrohet pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar dhe shlyerjes së pagesës së tarifës përkatëse.

2. Rregullat e e reregjistrimit, si dhe elementet e certifikatës së regjistrimit përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

3. Tarifat e regjistrimit dhe të reregjistrimit përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 16
Çregjistrimi

Ministri i Shëndetësisë, me propozimin e QKKB-së, urdhëron çregjistrimin e një bari nëse:

- a) bari nuk ka cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin, të deklaruara në dosjen e regjistrimit;
- b) bari nuk plotëson më standardet kohore zyrtare për cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin;
- c) shfaq efekte të dëmshme gjatë përdorimit edhe kur është konsumuar në përputhje me udhëzimet e sakta.

Neni 17
Procedura e përshpejtuar e regjistrimit

Për barnat e regjistruara në Agjencinë Europiane të Vlerësimit të Barnave (EMA), në Administratën Amerikane për Ushqimin dhe Barnat (FDA), si dhe për barnat e vendeve me të cilat ekzistojnë marrëveshje zyrtare të ndërsjella, regjistrimi i tyre realizohet sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji, por me procedurë të përshpejtuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 18
Botimi i regjistrimit të barnave

1. QKKB-ja përgatit dhe boton, periodikisht, çdo vit, regjistrin e barnave me çmimet përkatëse dhe bën përditësimin e tij çdo muaj.

2. QKKB-ja është e detyruar t'i njoftojë menjëherë subjektet farmaceutike për çdo bar të ri, që regjistrohet dhe për çdo bar të paregjistruar, që importohet me autorizim të veçantë.

KREU IV
HEDHJA NË TREG E BARNAVE

Neni 19
Leja e përdorimit

1. QKKB-ja lejon hedhjen në treg, nëpërmjet dhënies së lejes së përdorimit të barnave të regjistruara dhe të barnave të paregjistruara, që importohen me autorizim të veçantë, sipas pikës 2 të nenit 11 të këtij ligji.

2. Rregullat e dhënies së lejes së përdorimit miratohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 20
Pulla e kontrollit

1. Të gjitha barnat e hedhura në treg kanë, detyrimisht, të vendosur pullën e kontrollit të shpërndarë nga QKKB-ja, si dhe çmimin e shitjes me pakicë.
2. Elementet e pullës së kontrollit dhe procedurat për prodhim, shpërndarje dhe stampim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21
Barnat e dhuruara, mostrat promociionale dhe spitalore

Ndalohet tregtimi i barnave të dhuruara, i mostrave promociionale dhe spitalore, të cilat mbartin shenjë dalluese në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre.

KREU V
PROVAT KLINIKE DHE MBROJTJA E NJERËZVE GJATË KRYERJES SË TYRE

Neni 22
Provat klinike

1. Provat klinike me barna kryhen te njerëzit vetëm nëse konsiderohen si të domosdoshme: për dhënien e lejes së regjistrimit;
 - b) për të provuar efektin klinik dhe sigurinë e një bari në procesin e kërkimeve shkencore;
 - c) për të rivlerësuar efikasitetin dhe sigurinë e barit edhe pas hedhjes së tij në treg.
2. Provat klinike kryhen në institucionet shëndetësore të njohura zyrtarisht nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me standardet e praktikës së mirë klinike të miratuara edhe nga Ministri i Shëndetësisë.
3. Ndalohet kryerja e provave klinike te njerëzit pa i informuar dhe pa e marrë pëlqimin e tyre me shkrim.

Neni 23
Autorizimi për prova klinike

1. Autorizim për kryerjen e provave klinike te njerëzit me barna të paregjistruara jepet nga Komiteti Kombëtar i Etikës pas marrjes së miratimit nga bordi shkencor i institucionit që kryen studimin, QKKB-ja dhe KNB-ja.
2. Organizimi i strukturave dhe mënyra e funksionimit të komiteteve të etikës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI
TREGTIMI ME SHUMICË I BARNAVE

Neni 24
Tregtimi me shumicë i barnave

1. Çdo person juridik ose fizik, vendas apo i huaj, mund të ushtrojë veprimtari si shpërndarës farmaceutik vetëm pas marrjes së licencës nga Komisioni i Licencave pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Ministri i Shëndetësisë cakton përbërjen e këtij Komisioni dhe miraton rregulloren e funksionimit dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të tij.
3. Në shpërndarësin farmaceutik mund të shiten me shumicë edhe materiale mjekimi, aksesorë, artikuj higjieno-kozmetikë e dietetikë.

Neni 25
Licencimi

1. Licencimi i personave juridikë ose fizikë për tregtimin me shumicë të barnave bëhet sipas licencës së drejtuesit teknik, i cili është farmacist i diplomuar dhe me një përvojë pune mbi 2 vjet në sektorin farmaceutik.

2. Licenca jepet për një periudhë 5-vjeçare dhe pas kalimit të këtij afati ajo jepet për një periudhë 10-vjeçare.

3. Drejtuesi teknik përgjigjet për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale, që zhvillon shpërndarësi përkatës.

Neni 26
Praktikat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë

1. Kushtet dhe pajisjet e importuesit, eksportuesit dhe shpërndarësit farmaceutik duhet të jenë në përputhje me praktikat e ruajtjes dhe tregtimit të mirë të barit, sipas standardeve farmaceutike.

2. Praktikrat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë miratohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga importuesit, shpërndarësit dhe farmacitë.

Neni 27
Shitja me shumicë dhe dokumentacioni shoqërues

1. Shitja me shumicë e barnave kryhet në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar.

2. Shitja me shumicë e barnave bëhet kundrejt faturës dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, forma dhe elementet e të cilit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Financave.

3. Ndalohet shitja me pakicë e barnave nga importuesit ose shpërndarësit farmaceutikë.

Neni 28
Raportimi i veprimtarive

Fabrikuesit vendas, importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë japin periodikisht të dhëna pranë QKKB-së për veprimtarinë e tyre.

Neni 29
Tregtimi dhe eksportimi nga fabrikuesit vendas

1. Fabrikuesit vendas tregtojnë prodhimet e tyre vetëm në shpërndarësit farmaceutikë dhe i eksportojnë ato në vende të tjera.

2. Barnat e fabrikuara në vend, ekskluzivisht për eksport, lejohen të tregtohen në vende të tjera, pa qenë nevoja e regjistrimit të tyre në vendin tonë.

KREU VII
SHITJA ME PAKICË E BARNAVE

Neni 30
Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike

1. Shitja me pakicë e barnave kryhet vetëm nga farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, që funksionojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Farmacitë hapen në zonat urbane, në një largësi 100-150 metra, në varësi të dendësisë së popullsisë, një për çdo tre mijë banorë.

3. Farmacitë janë private ose publike.

4. Në farmaci bëhen edhe teste, si testi i shtatzanisë, i glicemisë, matja e tensionit, e peshës dhe e gjatësisë.

Neni 31

Drejtuesi teknik i farmacisë

Funksionin e drejtuesit teknik të farmacisë e ushtron çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe çdo shtetas i huaj, që plotëson këto kushte:

- a) ka arsimin e lartë për farmaci;
- b) ka një përvojë pune prej tre vjetësh;
- c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.

Neni 32

Licencimi

1. Licenca e drejtuesit teknik të farmacisë fillimisht jepet për një periudhë 5-vjeçare e pas kalimit të këtij afati jepet për një periudhë 10-vjeçare.

2. Kriteret e licencimit të farmacive dhe agjencive farmaceutike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Drejtuesi teknik i farmacisë është farmacisti i licencuar vetëm për një farmaci dhe nuk lejon të ushtrojë veprimtari tjetër në shërbimin farmaceutik.

Neni 33

Ushtrimi i veprimtarisë

Farmacia ushtron veprimtarinë e vet vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar me kontratë pune.

Neni 34

Personeli tjetër farmaceutik

Në farmaci punësohen me kontratë pune edhe farmacistë ose ndihmësfarmacistë, të cilët nuk pajisen me licencë, por regjistrohen në QKKB.

Neni 35

Agjencia farmaceutike

Në zonat rurale ku nuk ka farmaci hapen agjenci farmaceutike, me drejtues teknik ndihmësfarmacist.

Neni 36

Receta

1. Ndalohet shitja në farmaci ose agjenci farmaceutike e barnave pa recetën e mjekut, me përjashtim të barnave OTC, sipas një liste të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

2. Recetat e ekzekutuara ruhen në farmaci si më poshtë:

- a) 2 vjet recetat e zakonshme;
- b) 3 vjet recetat për barna narkotike e psikotrope;
- c) 5 vjet recetat për barna helme me veprim të fortë.

3. Në farmaci shiten edhe materiale mjekimi, aksesore, artikuj higjienokozmetikë e dietetikë.

Neni 37

Literatura e detyrueshme

Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike janë të detyruara të mbajnë literaturë të përditësuar: legjislacionin farmaceutik, regjistrin e barnave, listën e barnave që rimbursohen, formularin farmaceutik, formularë të barnave dhe formularë terapeutikë.

Neni 38

Orari

Orari i farmacisë dhe i shërbimit farmaceutik gjatë ditëve të pushimit dhe të festave caktohet nga organet e pushtetit vendor, në bashkëpunim me Urdhrin e Farmacistëve dhe me organizatat e tjera profesionale të farmacistëve.

Neni 39

Farmaci "Roje nate"

Shërbimi farmaceutik "Roje nate" në qendrat e mëdha urbane sigurohet nëpërmjet një ose më shumë farmacive me rotacion të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 40

Kufizimet për mjekët dhe stomatologët

1. Nuk lejohet ruajtja dhe përgatitja e barnave për shitje nga mjekët dhe stomatologët.
2. Mjeku dhe stomatologu ruajnë dhe përdorin në klinikat e tyre barna në lloje e sasi të mjaftueshme për ndihmën urgjente ose për procedurat e nevojshme, që lidhen me ushtrimin e profesionit, sipas përcaktimeve të bëra në listën e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 41

Përshkrimi i barnave dhe dhënia e recetës

Me udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë përcaktohen personat me kualifikim mjekësor, të cilëve u lejohet të përshkruajnë barna dhe të japin recetë, si dhe rregullat e përshkrimit të barnave.

Neni 42

Praktika mësimore

Farmacitë janë të detyruara të pranojnë studentë për zhvillimin e praktikës profesionale mësimore, sipas një kontrate të përbashkët, ndërmjet farmacisë dhe Fakultetit të Mjekësisë.

Neni 43

Barnat për përdorim nga njerëzit dhe farmacitë veterinare

1. Ndalohet përgatitja, përpunimi dhe tregtimi i barnave për përdorim nga njerëzit në farmacitë dhe agjencitë farmaceutike veterinare.
2. Barnat për përdorim nga njerëzit që mund të përdoren edhe te kafshët, tregtohen vetëm në depot dhe farmacitë që përcaktohen në këtë ligj.

Neni 44

Emblema

Emblema e farmacive dhe e agjencive farmaceutike është e njëjtë, një gotë me fron dhe një gjarpër. Forma, përmasat dhe ngjyra përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 45

Lista e barnave të detyrueshme

Lista e barnave të detyrueshme për farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për përballimin e nevojave të shërbimit farmaceutik përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

KREU VIII

IMPORTIMI DHE EKSPORTIMI I BARNAVE

Neni 46

Licencimi i veprimtarisë së import-eksportit

1. Çdo person juridik ose fizik, vendas apo i huaj, mund të ushtrojë veprimtari import-eksporti në fushën e tregtimit me shumicë të barnave dhe/ose lëndëve të para medikamentoze vetëm pas marrjes së licencës profesionale për drejtuesin teknik farmacist me përvojë pune 2-vjeçare në profesion nga Komisioni i Licencave në Ministrinë e Shëndetësisë.

2. Licencat profesionale për importimin dhe eksportimin e barnave jepen sipas kriterëve të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47

Autorizimi për importin e barnave të regjistruara

1. Importi i barnave të regjistruara bëhet në bazë të regjistrit të barnave dhe të autorizimit të importit, të lëshuar nga QKKB-ja.

2. Kriteret e dhënies së autorizimit dhe elementet e tij përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 48

Importi i barnave të paregjistruara

1. Importi i barnave të paregjistruara bëhet me autorizim të veçantë të ministrit të Shëndetësisë për çdo seri.

2. Importi i barnave të dhuruara bëhet me autorizim të veçantë të Drejtorit të Drejtorisë Farmaceutike në Ministrinë e Shëndetësisë për çdo seri.

3. Kriteret e dhënies së autorizimit dhe elementet e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 49

Importi i lëndëve të para dhe ndihmëse

1. Importi i lëndëve të para ndihmëse, i ambalazheve, i reagentëve etj., të cilët përdoren në procesin e fabrikimit të barnave mund të bëhet nga shpërndarësit dhe/ose vetë fabrikuesit, me autorizim të veçantë për çdo seri.

2. Kriteret e dhënies së autorizimit dhe elementet e tij përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

KREU IX ÇMIMET E BARNAVE

Neni 50 **Marzhet dhe çmimi i barnave**

1. Barnat tregtohen me çmime të caktuara për çdo vit kalendarik. Çmimet e barnave caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e komisionit të çmimeve, nëpërmjet negociimit me fabrikuesit vendas ose të huaj apo përfaqësitë e tyre, mbajtës të certifikatës së regjistrimit.
2. Në çmimet e barnave përfshihen dhe marzhet e fabrikimit dhe të tregtimit.

Neni 51 **Komisioni i Çmimeve të Barnave**

1. Në Komisionin e Çmimeve të Barnave bëjnë pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Ekonomisë, Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, Urdhrit të Farmacistëve dhe të shoqatave të pacientëve.
2. Struktura dhe mënyra e funksionimit të këtij Komisioni rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU X REKLAMA E BARNAVE

Neni 52 **Reklama dhe promovimi i barnave**

1. Lejohet reklama me mjetet e informimit masiv vetëm për barnat OTC, ndërsa për barnat e tjera bëhet promovim vetëm në literaturë ose në veprimtari shkencore profesionale.
2. Rregullat për reklamën dhe promovimin miratohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 53 **Kufizimet e reklamës**

1. Ndalohet reklama e barnave për efekte mjekuese, të cilat nuk janë shpallur në kohën e regjistrimit, si dhe fshehja e kundërlindimeve dhe e efekteve anësore të njohura.
2. Ndalohet reklama e lëndëve, që nuk përcaktohen si barna, sipas këtij ligji.

KREU XI KONTROLLI I BARNAVE

Neni 54 **Kontrolli i veprimtarive**

1. Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave është përgjegjëse për kontrollin e çdo veprimtarie në fushën farmaceutike.

Kjo qendër ushtron kontroll mbi:

- a) veprimtaritë e fabrikimit, mjediset dhe pajisjet që përdoren për fabrikimin e barnave;
- b) tregtimin me shumicë dhe pakicë, si dhe mbi kushtet e ruajtjes së barnave;
- c) lëndët e para medikamentoze dhe lëndët ndihmëse e materialet ambalazhuese;
- ç) barnat e importuara nga të gjitha subjektet e licencuara, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. QKKB-ja, për ushtrimin e detyrave, bashkëpunon me:

- a) strukturat e higjienës dhe të epidemiologjisë në shërbimin parësor;

- b) Institutin e Shëndetit Publik;
- c) autoritetet e Policisë së Shtetit;
- ç) autoritetet doganore dhe tatimore;
- d) Inspektoratin Veterinar;
- dh) Inspektoratin e Mjedisit.

3. Mënyrat e kontrollit dhe të bashkëpunimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 55

Kontrolli i barnave veterinare

QKKB-ja, në bashkëpunim me Laboratorin e Kontrollit Shtetëror Veterinar, kontrollon barnat që përdoren te kafshët, produktet e të cilave (mishi, qumështi, veza) përdoren si ushqim nga njerëzit.

Neni 56

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Ministri i Shëndetësisë, nëpërmjet Drejtorisë Farmaceutike, ushtron kontroll të rregullt mbi veprimtarinë e QKKB-së, për zbatimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë nga kjo qendër.
2. Rregullat e ushtrimit të kontrollit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU XII

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 57

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga inspektorët farmaceutikë si më poshtë:

a) shkelja e nenit 7, fabrikimi i barnave pa licencë, dënohet me sekuestrim të barnave dhe me 50 mijë lekë gjobë;

b) shkelja e nenit 8 pikat 1 dhe 2 dhe e nenit 9, fabrikimi i barnave pa autorizimin përkatës dhe ndryshimi në formën farmaceutike pa autorizim, dënohet me sekuestrim të barnave dhe me heqjen e licencës së subjektit, si dhe me 1 milion lekë gjobë;

c) shkelja e nenit 19, hedhja në treg e barnave të regjistruara pa leje përdorimi dhe e barnave të paregjistruara, pa autorizim të veçantë, dënohet me sekuestrim të barnave, me 500 mijë lekë gjobë dhe me heqjen e licencës;

ç) shkelja e pikës 1 të nenit 20, hedhja në treg e barnave pa pullën e kontrollit, dënohet me sekuestrim të barnave dhe me 500 mijë lekë gjobë dhe me heqjen e licencës;

d) shkelja e nenit 21, tregtimi i barnave të dhuruara dhe i mostrave, dënohet me sekuestrim të barnave, me 500 mijë lekë gjobë dhe me heqjen e licencës;

dh) shkelja e pikës 1 të nenit 24, tregtimi me shumicë i barnave pa licencë, dënohet me sekuestrim të barnave dhe me 500 mijë lekë gjobë;

e) shkelja e pikës 1 të nenit 26, mosrespektimi i praktikave të ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë, dënohet me 200 mijë lekë gjobë dhe në rast përsëritjeje me heqjen e licencës;

ë) shkelja e nenit 27, shitja e barnave me shumicë në mungesë të drejtuesit teknik ose farmacistit, dënohet me 50 mijë lekë gjobë; shitja e barnave me shumicë pa faturë shoqëruese dënohet me 100 mijë lekë gjobë dhe shitja me pakicë në shpërndarës dënohet me 50 mijë lekë gjobë;

f) shkelja e nenit 28, mosdhënia e informacionit periodik, dënohet me 50 mijë lekë gjobë dhe në rast përsëritjeje me heqjen e licencës;

g) shkelja e nenit 31, tregtimi i barnave me pakicë pa licencë, dënohet me sekuestrim të barnave dhe me gjobë 500 mijë lekë;

gj) shkelja e nenit 33, tregtimi i barnave me pakicë në mungesë të drejtuesit teknik ose farmacistit, dënohet me 100 mijë lekë gjobë dhe në rast përsëritjeje me heqjen e licencës;

h) shkelja e pikës 1 të nenit 36, tregtimi i barnave në farmaci ose agjenci farmaceutike pa recetën e mjekut, me përjashtim të barnave OTC, dënohet me 50 mijë lekë gjobë dhe në rast përsëritjeje me heqjen e licencës;

i) shkelja e pikës 1 të nenit 40, përgatitja dhe shpërndarja e barnave nga mjekët dhe stomatologët, dënohet me 50 mijë lekë gjobë;

j) shkelja pikës 1 të nenit 43, shitja e barnave që përdoren nga njerëzit në farmacitë veterinare, dënohet me 10 mijë lekë gjobë dhe me propozim të Ministrit të Bujqësisë për heqjen e licencës;

k) shkelja e nenit 45, mungesa e barnave të detyrueshme në farmaci dhe në agjenci farmaceutike, dënohet me 10 mijë lekë gjobë;

l) shkelja e nenit 46, import-eksporti i barnave pa licencën profesionale, dënohen me sekuestrim të barnave dhe me 1 milion lekë gjobë;

ll) shkelja e nenit 49, importi pa autorizim i lëndëve të para dhe ndihmëse, dënohet me sekuestrim dhe me 500 mijë lekë gjobë dhe në rast përsëritjeje me heqjen e licencës;

m) shkelja e nenit 50, shitja me çmime të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, dënohet me 500 mijë lekë gjobë dhe në rast përsëritjeje me heqjen e licencës;

n) shkelja e neneve 52 e 53, reklamimi i barnave jo OTC, në kundërshtim me rregulloren për reklamimin dhe promocionin, dënohet me 100 mijë lekë gjobë dhe në rast përsëritjeje me heqjen e licencës.

Neni 58

Pezullimi i veprimtarive të licencuara dhe heqja e licencës

1. Inspektorët farmaceutikë në rast se vërejnë kundërvajtje administrative, në përputhje me nenin 57, urdhërojnë pezullimin e veprimtarisë deri në shqyrtimin e çështjes nga Komisioni i Licencave në Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe bllokimin ose konfiskimin e barnave.

2. Komisioni i Licencave, në mbledhjen më të parë, vendos heqjen e licencës të subjekteve që kanë kryer shkeljet sipas nenit 57 të këtij ligji.

Neni 59

Blokimi, konfiskimi dhe asgjësimi i barnave

Barnat e bllokuara ose të konfiskuara, që janë jashtë standardeve të vendosura, asgjësohen me procesverbal të rregullt, sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, me shpenzimet e subjektit që ka bërë shkeljen, ndërsa kur ato janë të përdorshme, kalojnë në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë, me dokumentacion të rregullt.

Neni 60

Ankimi

1. Ankimi kundër vendimeve sipas neneve 57, 58 e 59 të këtij ligji bëhet në mbështetje të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

2. Ekzekutimi i dënimeve me gjobë, sipas neneve të këtij ligji, bëhet në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 61

Shfuqizimet

Ligji nr.7815, datë 20.4.1994 "Për barnat", shfuqizohet.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4425, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**LIGJ
Nr.9340, datë 23.12.2004**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË
INVESTIMEVE, PËR KONTRATËN FINANCIARE PËR PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË
TEC-IT NË VLORË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pikat 1 e 2 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për kontratën financiare për projektin e ndërtimit të TEC-it në Vlorë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4441, datë 31.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Banka Europiane e Investimeve
Porojekti i TEC-it Vlorë (Shqipëri)

**MARRËVESHJE GARANCIE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE**

Kjo Marrëveshje lidhet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, që këtu e më poshtë do të njihet si “Garantuesi”, për palën e parë dhe Bankës Europiane të Investimeve me seli në Luksemburg, që këtu e më poshtë do të njihet si “Banka”,
për palën e dytë.

Duke pasur parasysh që:

Një kontratë financiare e titulluar “Projekti i TEC-it të Vlorës” ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (KESH sh.a. që këtu e më poshtë i quajtur “Huamarrësi”) kanë nënshkruar më 29 shtator 2004 kontratën (që këtu e më poshtë të quajtur “Kontratë financiare”) Banka ka vendosur një kredi në një shumë totale prej 40 000 000

(dyzet milionë) euro, në favor të Huamarrësit për t'u përdorur për projektin që përfshin studimin, projektimin dhe ndërtimin e një TEC-i me cikël të kombinuar pranë qytetit të Vlorës, në juglindje të Shqipërisë (këtu e më poshtë të quajtur "Projekti").

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje garancie (këtu e më poshtë të quajtur "Kjo Marrëveshje") Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon se huaja financiare me kushtet sipas kontratës financiare është brenda kuadrit të Marrëveshjes që përcakton aktivitetet e Bankës në Republikën e Shqipërisë siç është konkluduar më 5 shkurt 1998 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës.

Detyrimet e Bankës sipas kontratës financiare kushtëzohen nga zbatimi dhe livrimi nga Garantuesi i kësaj Marrëveshjeje.

Konkluzioni i kësaj Marrëveshjeje është autorizuar me një vendim qeverie.

Si rrjedhojë, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 **Kontrata financiare**

1.01 Garantuesi është vënë në dijeni për termat, kushtet dhe klauzolat e kontratës financiare, një kopje origjinale e së cilës siç është nënshkruar nga palët dhe do t'i dorëzohet atij.

Termat e përcaktuar në kontratën financiare do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.

Neni 2 **Garancia**

2.01 Garantuesi, si detyrues primar dhe jo thjesht si garantues, garanton kryerjen e plotë dhe pikë për pikë të të gjitha detyrimeve të pagesës nga ana e Huamarrësit përkundrejt Bankës sipas kontratës financiare në përputhje me principalin e parasë, interesin pa ndonjë kufizim, komisionet dhe të gjitha detyrimet e tjera, shpenzimet dhe shumat, të cilat herë pas here mund të bëhen të pagueshme ose sipas kushteve të kontratës financiare (çdo shumë e garantuar në mënyrë të tillë këtu e më poshtë do të referohet si shumë e garantuar).

Neni 3 **Zbatimi i garancisë**

3.01 Kërkesa mund të bëhet këtu e më poshtë sapo Huamarrësi nuk ka kryer në një datë pagese normale, sipas kërkesës për ripagesat e mëparshme, të gjitha ose pjesë e detyrimeve të garantuara sipas nenit 2.

3.02 Garantuesi këtu heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo kundërshtim ose përjashtim në ligj i zbatimit total ose pjesor të kësaj Marrëveshjeje. Ai merr përsipër të kryejë të gjitha detyrimet e tij sipas kërkesës me shkrim nga Banka kurdo që bëhet kërkesa dhe të paguajë shumat e pagueshme pa asnjë kufizim ose kusht pa pasur nevojë për t'u pajisur nga Banka me ndonjë evidencë të veçantë në mbështetje të kërkesës së tij, përveç se shkakun e kërkesës sipas kësaj Marrëveshjeje. Në veçanti, Banka nuk është e detyruar të vërtetojë se ajo ka ndërmarrë ndonjë veprim ndaj Huamarrësit dhe nuk është e detyruar, përpara zbatimit të kësaj Marrëveshjeje të zbatojë garancitë ose të zbatojë ndonjë garanci tjetër se Huamarrësi ose një palë e tretë mund të kenë krijuar.

3.03 Çdo pagesë e një shume të garantuar nga garantuesi duhet të bjerë 3 ditë biznesi të Luksemburgut pas datës së kërkesës përkatëse dhe do të bëhet në monedhën e shumës së garantuar dhe në llogarinë e specifikuar në kërkesë.

3.04 Në rast se Banka bën ndonjë kërkesë këtu e më poshtë, Garantuesi do të ketë të drejtën t'i paguajë menjëherë Bankës, me një pagesë të plotë dhe përfundimtare detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, llogaritjen e huasë së prapambetur në datën e një pagese të tillë, interesin e rritur deri në këtë datë dhe çdo shumë tjetër të garantuar që është pastaj e pagueshme nga ana e

Huamarrësit, së bashku me çdo kompensim, i cili mund të ketë qenë i pagueshëm nga Huamarrësi sipas nenit 4.02 B të kontratës financiare, nëse kjo e fundit ka parapaguar vullnetarisht llogaritjen e huasë në datën e pagesës sipas paragrafit 3.04.

3.05 Garancia sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbesë në fuqi deri sa të gjitha shumat e garantuara janë paguar ose shkarkuar plotësisht dhe pa kushte.

Neni 4 **Zëvendësimi**

4.01 Kur Garantuesi i ka bërë një pagesë Bankës, ajo është zëvendësuar në masën e një pagese të tillë, të të drejtave dhe veprimeve në lidhje me pagesën e thënë që Banka ka përkundrejt Huamarrësit, kjo e drejtë e zëvendësimit nuk do të kërkohej në dëm të Bankës.

Neni 5 **Modifikimi i kontratës financiare**

5.01 Subjekti i paragrafit 5.02, Banka mund të bjerë dakord për çdo modifikim të kontratës financiare, i cili nuk i rrit shumat e pagueshme nga Huamarrësi këtu. Banka do të njoftojë Garantuesin për çdo modifikim të tillë.

5.02 Banka mund t'i garantojë Huamarrësit në përputhje me datën e duhur të pagesës të çdo shume të garantuar, një shtyrje afati deri në 3 muaj. Garantuesi do të njoftohet për çdo shtyrje afati.

5.03 Banka nuk mund të ndryshojë kushtet e kontratës financiare me përjashtim të paragrafëve 5.01 dhe 5.02 ose pa pasur më parë miratimin me shkrim të Garantuesit, miratim i cili nuk mund të mohohet pa asnjë arsye.

Neni 6 **Premtime të veçanta dhe garancia**

6.01 Garantuesi merr përsipër të sigurojë që përshtatja e tarifave do të zbatohet në përputhje me procedurat e parashtruara në ligjin kombëtar të Entit Rregullator të Sektorit Energjetik, me qëllim që të sigurojë kryerjen financiare të kënaqshme të Huamarrësit dhe të reflektojë koston e tij të furnizimit.

6.02 Garantuesi merr përsipër që duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicionin e tij sipas ligjit shqiptar të ndihmojë Huamarrësin për marrjen e lejeve, licencave, aprovimeve ose miratimeve të domosdoshme për punimet që do të kryhen për projektin.

6.03 Garantuesi merr përsipër që të mos pengojë Huamarrësin në zbatimin e këtij plani investimi.

6.04 Garantuesi merr përsipër të mbështesë programin e ko-menaxhimit me Huamarrësin deri në fund të vitit 2006.

6.05 Garantuesi merr përsipër të mbështesë përpjekjet e Huamarrësit për të eliminuar subvencionimin e tarifave të energjisë për të gjithë konsumatorët deri në fund të vitit 2005 dhe për kompanitë e ujësjellësve deri në fund të vitit 2007.

6.06 Garantuesi merr përsipër të ndihmojë Huamarrësin në ngritjen e një filiali tërësisht vetjak për operimin dhe pronësinë e projektit.

Neni 7 **Garancia e Komunitetit European**

7.01 Garancia e krijuar këtu e më poshtë është e pavarur nga çdo garanci tani ose pas kësaj që i jepen Bankës nga Komuniteti European (KE). Garantuesi këtu e më poshtë heq dorë nga çdo e drejtë kontributi ose kompensimi nga KE.

7.02 Nëse pagesa i është bërë Bankës nga KE për llogari të çdo shume garancie KE do të zëvendësohet nga të drejtat e Bankës këtu dhe KE mund të rimarrë nga garantuesi çdo shumë të prapambetur sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8
Taksat, detyrimet dhe shpenzimet

8.01 Taksat ose detyrimet fiskale të pagueshme për çdo autoritet në Republikën e Shqipërisë, kostot ligjore dhe shpenzimet e tjera që janë bërë për zbatimin ose implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga Garantuesi. Garantuesi do t'i bëjë pagesat këtu pa hequr ose pa mohuar një llogaritje të taksës ose të detyrimeve fiskale.

Neni 9
Ligji dhe juridiksioni

9.01 Kjo Marrëveshje do të drejtohet nga ligjet e Grand Duchy e Luksemburgut.

9.02 Konfliktet që dalin nga kjo Marrëveshje do t'i paraqiten juridiksionit të gjykatës së drejtësisë të KE-së.

Palët e kësaj Marrëveshjeje këtu dhe më poshtë heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e kësaj gjykate. Një vendim i kësaj gjykate i dhënë duke u bazuar në paragrafin 8.02 do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët pa kufizim ose vërejtje.

Neni 10
Dispozita përfundimtare

10.01 Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna këtu nga njëra palë për palën tjetër do t'i dërgohen kësaj të fundit në adresën e përcaktuar më poshtë ose në adresa të tjera që i adresuari ka dhënë më parë me shkrim, si adresën e tij të re për këtë qëllim; me kusht që njoftimet për Garantuesin do të dërgohen në adresën e përmendur sipas (1) vetëm nëse ka të bëjë me procesin gjyqësor nëse pezullohet ose rrezikohet, në secilin rast ato do të dërgohen në adresën e përmendur sipas (2) më poshtë ku Garantuesi zgjedh banesën:

Për Garantuesin:

1) Ministria e Financave Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë-Shqipëri

2) Misioni i Republikës së Shqipërisë për Bashkimin Europian

Rue Tenboch 30

B- 1000 Bruksel

Për Bankën:

1) Boulevard Konrad Adenauer 100

L -2950 Luxembourg

10.02 Deklamimet janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

10.03 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën do të ratifikohet ligji.

Në prani të palëve këtu dhe më poshtë kanë bërë që kjo Marrëveshje të zbatohet në emër të tyre në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

Tiranë, më 6.12.2004

Luxembourg 6.12.2004

Nënshkruar për dhe në emër të Republikës
së Shqipërisë
Arben Malaj
Ministër i Financave

Nënshkruar për dhe në emër të Bankës
Europiane të Investimeve
D.R.R.Dunnett R Nassa Bernucci

BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE
TERMOCENTRALI I VLORËS
KONTRATË FINANCIARE NDËRMJET BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE
DHE KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SH.A.

Kjo kontratë lidhet ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve me seli në adresën 100 boulevard Konrad Adenauer, Luxembourg, Grand Duchy të Luksembourg, përfaqësuar nga z.Gerlando Genuardi, zëvendëspresident, që këtu e më poshtë do të quhet “Banka”, nga njëra anë dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., shoqëri aksionare, regjistruar në gjykatën e Tiranës me vendim nr.12728, datë 6 nëntor 1995, përfaqësuar nga Drejtori Përgjithshëm, z.Andis Harasani, që këtu e më poshtë do të quhet “Huamarrësi” nga ana tjetër.

Duke pasur parasysh që:

1. Komuniteti European dhe Shqipëria kanë arritur në një “Marrëveshje ndërmjet Komunitetit Ekonomik European dhe Republikës së Shqipërisë, për tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik në mbështetje të përpjekjeve të Shqipërisë për ndërmarrjen e reformave politike dhe ekonomike (që këtu e më poshtë do të quhet “Marrëveshja Europiane”).

2. Në kuadrin e Marrëveshjes Europiane dhe sipas vendimit të Këshillit 2000/24 të 22 dhjetorit të vitit 1999, Bordi i Guvernatorëve të Bankës më 28 mars 2000 autorizoi lejimin e dhënies së huave të tjera për projekte investimi në Shqipëri.

3. Huamarrësi deklaron se ka ndërmarrë një projekt, (këtu e më poshtë referohet si “Projekti”) që konsiston në studimin, projektimin dhe ndërtimin e një TEC-i me cikël të kombinuar pranë qytetit të Vlorës në jugperëndim të Shqipërisë, cili do të operojë në pronësi të plotë nga TEC-i Vlorë, siç është përshkruar më hollësisht në përshkrimin teknik (këtu e më poshtë referohet si “përshkrim teknik”) të vendosur në skedulin A.1 këtu.

4. Kostoja totale e projektit sipas vlerësimit të Bankës është 110 500 000 euro (110.5 milionë euro).

5. Huamarrësi ka deklaruar se ai do të financojë projektin si më poshtë:

	euro milion
Fondet e vetë Huamarrësit	10.2
Huaja nga BERZH	40.0
Huaja nga SHZHN	
Përmes Republikës së Shqipërisë	20.3
Huaja e kërkuar nga BEI	40.0
Total	110.5

6. Për të plotësuar financimin e kërkuar në deklaminin 5, Huamarrësi i ka kërkuar Bankës t'i japë një kredi në shumën prej 40 milionë euro:

7. Në përgjigje të kërkesës së Huamarrësit duke qenë të kënaqur se financimi i projektit bëhet brenda funksioneve të tij dhe duke u mbështetur midis të tjerave në deklaratat dhe faktet të cituara në këto deklamime, Banka është e gatshme t'i japë Huamarrësit një kredi prej 40 milionë eurosh, sipas kësaj kontrate financiare (këtu e më poshtë e quajtur “Kontratë”).

8. Një kuadër Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bankës që drejton aktivitetet e bankës në Shqipëri (këtu e më poshtë e quajtur “Kuadër Marrëveshje”) u nënshkrua nga Republika e Shqipërisë dhe Banka më 5 shkurt 1998 dhe është e aplikueshme për këtë kontratë financiare.

9. Sipas nenit 3 të kuadër Marrëveshjes, Republika e Shqipërisë ka rënë dakord që interesat dhe të gjitha pagesat e tjera që i detyrohet Bankës dhe që mund të dalin nga zbatimi i veprimtarive të parashikuara sipas kuadër marrëveshjes, si dhe asetet dhe të ardhurat e Bankës lidhur me këto veprimtari, do të përjashtohen nga taksat.

10. Sipas nenit 4 të kuadër Marrëveshjes, Republika e Shqipërisë ka rënë dakord që gjatë gjithë kohës së çdo veprimtarie financiare përfshirë në këtë kuadër Marrëveshje, Republika e Shqipërisë:

a) do të sigurojë (i) që përfituesit mund t'i konvertojnë në monedhë tërësisht të konvertueshme, sipas këmbimit monetar në treg, shumat në monedhën kombëtare të Shqipërisë të nevojshme për pagesat kohore të të gjitha shumave që i detyrohet Bankës lidhur me huatë dhe garancitë për çdo projekt dhe (ii) këto shuma do të bëhen të transferueshme menjëherë dhe në mënyrë efektive;

b) do të sigurojë (i) që Banka mund t'i konvertojë në monedhë tërësisht të konvertueshme, sipas këmbimit monetar në treg, shumat në monedhën kombëtare të Shqipërisë, që Banka merr nga pagesat lidhur me huatë dhe garancitë ose çdo aktivitet tjetër, dhe që Banka mund t'i transferojë lirisht, menjëherë dhe në mënyrë efektive shumat e konvertuara në këtë mënyrë; ose sipas dëshirës së Bankës (ii) që këto shuma mund t'i dërgojë brenda territorit të Shqipërisë.

11. Bordi i drejtorëve të Huamarrësit ka autorizuar marrjen e shumës prej 40 milionë eurosh të përfaqësuara nga kredia e thënë sipas termave dhe kushteve të parashtruara këtu dhe siç është certifikuar në formën e përcaktuar në aneksin I që kjo hua është brenda mundësive bashkëpunuese të Huamarrësit.

12. Detyrimet financiare të Huamarrësit këtu e më poshtë do të garantohen nga një garanci në formë dhe përmbajtje të aprovuar nga Banka (që këtu e më poshtë do të quhet "Garanci") e lëshuar nga Republika e Shqipërisë (që këtu e më poshtë do të quhet "Garantuesi").

13 Statuti i Bankës garanton se Banka do të sigurojë se fondet e saj do të përdoren sa më racionalisht që të jetë e mundur në interes të komunitetit dhe për rrjedhojë termat dhe kushtet e operimeve të huasë së bankës do të jenë në përputhje me politikat e komunitetit.

14. Referencat e këtushme të neneve, deklamimeve, skeduleve dhe anekseve i referohen përkatësisht neneve dhe deklamimeve, skeduleve dhe anekseve të kësaj kontrate; dhe termat e mëposhtme kanë respektivisht kuptimet që u janë caktuar atyre në deklamimet dhe nenet e specifikuar pas kësaj:

Termat e përcaktuar në trupin e kontratës	nenet ose recitalet
Pranimi i afatit të fundit	4.02C
Kontrata	Deklamimi (7)
Krediti	1.01
Njoftimi për disbursimin	1.02 C
Kërkesa për disbursim	1.02 B
Përqindja e shpërndarë e huasë së BEI	4.02B (1)
Mjedisi	6.06
Marrëveshja europiane -	Deklamimi (1)
Norma fikse	3.01 A
Transhi i normës fikse	1.02 B
Garantuesi	Deklamimi (12)
Garancia	Deklamimi (12)
Huaja	2.01
Rasti i humbjes së përqindjes	4.03 A(4)
Dita e biznesit së Luksemburgut	1.02 D
Rrethana të pavolitshme materiale	1.04 B
Data e maturimit	4.01 C
Njoftimi	1.06 B
Data e pagesës	3.03
Shuma e parapagesës	4.02 A
Data e parapagesës	4.02 A
Njoftimi për parapagesë	4.02 A
Projekti	Deklamimi (3)
Shpenzimet përcaktuese	1.04 A
Ditë 3-mujori	3.01 B
Ditë përkatëse biznesi	3.03
Përqindje përkatëse interbankare	1.02 B
Skedulimi i datës së disbursimit	1.02 C

Interesi i sigurisë	7.02
Shpërndarja	3.01C
Përshkrimi teknik	Deklamimi (3)
Periudha e huasë	4.03 A
Kësti	1.02 A
Kësti me përqindje të ndryshueshme	1.02 B
VS-FR	3.01B
Periudha referuese VSFR	3.01 B
KëstiVSFR	1.02 B
Termat e përcaktuar në skedule	skeduli
EURIBOR	B
Data e rivendosur	B
Për sa më lart u ra dakord, si më poshtë:	

Neni 1 Kredia dhe disbursimi

1.01 Shuma e kredisë

Nëpërmjet kësaj kontrate Banka jep në favor të Huamarrësit, dhe Huamarësi pranon një kredi (këtu e më poshtë e quajtur “Kredi”) në një shumë prej 40 000 000 euro (dyzet milionë euro) për financimin e projektit.

1.02 Procedurat e disbursimit

A. Këstet (Transhe)

Banka do ta disbursojë kredinë deri në 10 këste. Shuma e çdo kësti, nëse nuk është balancë e padisbursuar e kredisë, do të jetë një minimum prej 3 milionë euro. Një këst i kërkuar nga Huamarrësi në përputhje me nenin 1.02 B këtu e më poshtë do të referohet si këst (transh).

B. Kërkesë disbursimi

Herë pas here deri më 31 korrik 2008, Huamarrësi mund t’i dërgojë Bankës një kërkesë me shkrim (një kërkesë disbursimi) sipas formës të përcaktuar në skedulin C.2, për disbursimin e një kësti. Kërkesa e disbursimi do të specifikojë:

- i) shumën e kërkuar për disbursim sipas këstit;
 - ii) datën e parapëlqyer të disbursimit, e cila do të jetë një ditë biznesi (siç përcaktohet në nenin 5.01), që kupton se Banka mund ta disbursojë këstin deri në katër muaj kalendarikë nga data e kërkesës së disbursimit;
 - iii) nëse kësti ka:
 - a) një normë fikse të interesit të përcaktuar sipas nenit 3.01 A (një normë fikse kësti);
 - b) një normë të ndryshueshme të interesit të përcaktuar sipas nenit 3.01 B (këst me normë të ndryshueshme ose kësti VSFR);
 - iv) pagesën e preferuar periodike të interesit për këstin e zgjedhur në përputhje me nenin 3.01;
 - v) datat e preferuara të pagesave të zgjedhura në përputhje me nenin 5.01;
 - vi) termat e preferuara për ripagesën e principalit, të zgjedhur në përputhje me nenin 4.01.
- Huamarrësi mund të përcaktojë gjithashtu normën e aplikueshme të interesit që zbatohet për këstin, nëse ky interes është treguar më parë nga Banka, pa angazhim.

Për qëllimet e kësaj kontrate “Përqindje e bankës kombëtare përkatëse” do të thotë EURIBOR.

Huamarrësi do t’i sigurojë Bankës evidencën e personave që do të bëjnë kërkesën e disbursimit që këtu e më poshtë janë të autorizuar ta bëjnë këtë.

Subjekt i paragrafit të dytë të fundit të nenit 1.02 C, çdo kërkesë disbursimi është e përvokueshme.

C. Njoftim disbursimi

Midis dhjetë dhe pesëmbëdhjetë ditë para datës së disbursimit të një kësti, Banka do t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim (që këtu e më poshtë do të quhet "Njoftim disbursimi"), nëse kërkesa e disbursimit është në përputhje me nenin 1.02 B, i cili do të specifikojë:

i) shumën e këstit që do të disbursohet;

ii) normën e interesit të aplikueshëm të këstit sipas nenit 3.01;

iii) datat e aplikueshme të pagesës;

iv) kushtet për ripagesën e principialit dhe pagesat periodike të interesit; dhe

v) datën (që këtu e më poshtë do të quhet si data e skeduar e disbursimit), në të cilën është skeduar për t'u disbursoar kësti, disbursim që në çdo rast është subjekt i kushteve të nenit 1.04.

Nëse një ose më shumë elemente të përcaktuara në njoftimin e disbursimit nuk përkojnë me elementet përkatëse në kërkesën e disbursimit, Huamarrësi, brenda tri ditëve, kur Banka është e hapur në Luksemburg pas marrjes së njoftimit të disbursimit, mund të revokojë kërkesën e disbursimit duke njoftuar Bankën dhe pas kësaj kërkesa dhe njoftimi përkatës i disbursimit nuk do të kenë me efekt.

Për qëllimet e kësaj kontrate (Ditë biznesi në Luksemburg) nënkupton ditën në të cilën bankat tregtare janë të hapura për biznes në Luksemburg.

D. Kushtet dhe mekanikat e disbursimit

Disbursimi i çdo kësti do të bëhet në një llogari tjetër bankare të Huamarrësit, të cilën Huamarrësi do t'ia bëjë të ditur Bankës në kërkesën e disbursimit për këstet.

1.03 Monedha e disbursimit

Për arsye vlefshmërie, Banka do të disbursojë çdo këst në euro.

1.04 Kushtet për disbursim

A. Disbursimi i këstit të parë

Disbursimi i këstit të parë, sipas nenit 1.02, do të jetë subjekt i përmbushjes së kushteve të mëposhtme sipas kënaqësisë së Bankës në ose para paraqitjes nga ana e Huamarrësit të kërkesës së disbursimit.

i) Banka duhet të marrë një mendim ligjor në gjuhën angleze, për zbatimin e duhur të kësaj kontrate nga Huamarrësi dhe për dokumentacionin përkatës; ky mendim duhet të jetë i pranueshëm nga të gjitha aspektet për bankën dhe duhet të mbështetet nga një rezolutë e Huamarrësit që autorizon hyrjen e tij në kontratë;

ii) Garantuesi duhet të ketë marrë një mendim të kënaqshëm ligjor në gjuhën angleze, lëshuar nga ose në emër të Ministrit të Drejtësisë të Shqipërisë, ku konfirmohet se dispozitat e marrëveshjes së garancisë të përmendura në nenin 7.01 janë plotësisht në fuqi dhe efektive dhe se kjo Marrëveshje është e vlefshme, e detyrueshme dhe në fuqi në Shqipëri, në përputhje me termat e saj;

iii) licencat dhe lejet e nevojshme për zbatimin e projektit siç janë listuar në aneksin II duhet të jenë marrë nga Huamarrësi;

iv) Banka duhet të ketë marrë evidencë nga Huamarrësi për personat që janë të autorizuar të firmosin kërkesat për disbursim dhe modelin origjinal të këtij personi apo personave, së bashku me një përkthim në anglisht;

v) Banka duhet të jetë e kënaqur që marrëveshjet e kredisë të përmendura në deklaramimin 5 janë zbatuar dhe se kushtet për disbursim tani e më poshtë janë plotësuar dhe mbesin të kënaqshme;

vi) Banka duhet të ketë marrë kopjen e kontratës ose të kontratave për zbatimin e projektit, kontratat e të cilave duhet të jenë zbatuar sipas termave të kënaqshëm për bankën (të gjitha shpenzimet për këto pika, duke përfshirë asistencën teknike, do të referohen si "Shpenzime kualifikuese");

vii) të gjitha aprovimet e nevojshme për kontrollin mbi këmbimin, nëse ka, duhet të bëhen për të lejuar Huamarrësin të marrë disbursimet këtu e më poshtë, për të ripaguar huanë dhe për të paguar interesat dhe të gjitha shumat e tjera që vijnë nga detyrimet e tjera; këto aprovime bëhen për të zgjeruar hapjen dhe administrimin e llogarive në të cilat Huamarrësi drejton Bankën për disbursimin e kredisë.

B. Disbursimet pasuese

Disbursimi i kësteve pasuese, sipas nenit 1.02, që do të ndjekin të parin, do të jenë subjekt i përmbushjes së kushteve të mëposhtme për Bankën në ose para paraqitjes nga Huamarrësi të kërkesës së disbursimit.

i) fonde të mjaftueshme, duke përfshirë burimet e fondeve që i referohen deklamimit 3, vazhdojnë të jenë të disponueshme për të siguruar përfundimin dhe zbatimin në kohë të projektit në përputhje me skedulin A. 1;

ii) shuma e kështit do të jetë në përpjestim me shumën e disbursimit korrespondues sipas huasë së BERZH-it të përmendur në deklamimin (5) në përputhje me shpenzimet e projektit, duke marrë në konsideratë raportet ndërmjet shumave respektive të kredisë të përcaktuara në deklamimin (5);

iii) duke ndjekur zbritjen e kështit përkatës, shuma totale e kreditit të zbritur nuk do t'i kalojë shpenzimet totale të financuara nga Banka dhe që kanë ndodhur ose janë kryer kontraktualisht nga Huamarrësi në përputhje me projektin me anën e shpenzimeve kualifikuese;

iv) nëse nuk ka ndodhur ndonjë rast i pafavorshëm material në lidhje me Huamarrësin që nga data e kësaj kontrate; me kushtet që rast i pafavorshëm material nënkupton, në lidhje me Huamarrësin, çdo rast apo kusht që ndikon atë ose ndonjë nga subvencionuesit e tij, të cilët, sipas logjikës së bankës, dëmton materialisht mundësinë e Huamarrësit për përmbushjen e detyrimeve financiare dhe detyrimeve të tjera sipas kësaj kontrate;

v) marrjen nga Banka të një certificate nga ana e Huamarrësit në formën e skedulit C.1 që daton jo më vonë se shtatë ditë para datës së kërkesës për disbursim.

C. Për llogaritjen e shumave të shpenzuara në euro, Banka do të zbatojë kursin e këmbimit të aplikueshëm në ditën e tridhjetë para datës së kërkesës së disbursimit.

D. Nëse ndonjë pjesë e evidencës së dhënë nga Huamarrësi sipas nenit 1.04 B, nuk është e kënaqshme për Bankën, Banka mund të disbursojë në mënyrë proporcionale më pak se shuma e kërkesës së disbursimit.

1.05 Shtyrja e afatit të disbursimit

A. Kushtet për shtyrjen e afatit

Banka, me kërkesën e Huamarrësit, do të shtyjë afatin e disbursimit të çdo kësti në tërësi ose pjesërisht në një datë të specifikuar nga Huamarrësi duke qenë një datë që bie jo më shumë se gjashtë muaj nga data e skeduluar e disbursimit. Në këtë rast, Huamarrësi do të paguajë dëmshpërblim për shtyrjen e afatit siç është përcaktuar në paragrafin B më poshtë. Çdo kërkesë për shtyrje afati do të ketë ndikim në lidhje me kështin vetëm nëse ai është bërë së paku 7 ditë biznesi Luksemburgu para datës së skeduluar të disbursimit.

Nëse ndonjë nga kushtet që i referohen nenit 1.04 nuk plotësohen sipas datës së specifikuar dhe datës së skeduluar të disbursimit, disbursimi do të shtyhet në një datë të rënë dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit që të bjerë jo më pak se 7 ditë biznesi në Luksemburg, duke zbatuar plotësimin e të gjitha kushteve të disbursimit.

B. Shtyrja e afatit të dëmshpërblimit

Nëse disbursimi i ndonjë kësti shtyhet ose me kërkesë të Huamarrësit ose për shkak të mosplotësimit të kushteve të disbursimit, Huamarrësi, me kërkesën e Bankës, do të paguajë dëmshpërblim për shumën mbi të cilën shtyhet disbursimi. Ky dëmshpërblim do të rritet nga data e skeduluar e disbursimit deri në datën aktuale të disbursimit ose, siç mund të paraqitet rasti, deri në datën e anulimit të kështit në një normë të barabartë me R1 —R2, ku:

R1 nënkupton normën e interesit që do të aplikohet herë pas herë sipas nenit 3.01 dhe njoftimin përkatës për disbursim, nëse kësti është disbursuar në datën e skeduluar të disbursimit dhe

R2 nënkupton përqindjen përkatëse të Bankës kombëtare më pak se 0.125% (12.5 pikë), me kusht, që për qëllimin e përcaktimit të normës përkatëse të Bankës kombëtare në lidhje me nenin 1.05, periudhat përkatëse në skedulin B do të jenë periudha në vazhdim të një muaji që nis më datën e skeduluar të disbursimit.

Për më tepër, dëmshpërblimi:

i) nëse shtyrja e afatit e kalon një muaj në kohëzgjatje, dëmshpërblimi do të rritet në fund të çdo muaji dhe do të paguhet në përputhje me nenin 1.07;

ii) do të llogaritet duke përdorur marrëveshjen për numërimin e ditës të aplikueshme tek R1;

iii) atje ku R2 e kalon R1, do të vendoset në zero dhe do të paguhet në përputhje me nenin 1.07.

C. Anulimi i disbursimit të një kësti të shtyrë

Banka duhet gjithashtu, që me anë të njoftimit të Huamarrësit, të anulojë një këst të njoftuar (siç përcaktohet në nenin 1.06 B), i cili është shtyrë sipas nenit 1.05 A për më shumë se gjashtë muaj së bashku. Shuma e anuluar do të mbetet e disponueshme për disbursim sipas nenit 1.02.

1.06 Anulimi dhe pezullimi

A. E drejta e Huamarrësit për anulim

Huamarrësi nëpërmjet një njoftimi me shkrim që mund t'i bëjë Bankës mund të anulojë, të gjithë ose një pjesë të padisbursuar të kredisë, në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm. Megjithatë, njoftimi nuk do të ketë efekt mbi këstin data e skedulimit të rimbursimit të të cilit bie brenda 7 ditë biznesi të Luksemburgut duke ndjekur datën e njoftimit.

B. E drejta e Bankës për anulim dhe pezullim

Banka nëpërmjet një njoftimi me shkrim për Huamarrësin mund të anulojë, të gjithë ose një pjesë të padisbursuar të kredisë, në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm:

i) për ndonjë rast që përmendet në nenin 10.01;

ii) të ruajë në përputhje me këstin për të cilin Banka ka nxjerrë një njoftim disbursimi (ky këst këtu e më poshtë do të referohet si i njoftuar) nëse krijohen kushte të veçanta, që sipas mendimit të Bankës, do të mund të ndikonin në aksesin e Bankës në tregun e kapitaleve.

Për më tepër, nëse Banka mund të anulojë kredinë sipas nenit 4.03A, ajo gjithashtu mund ta pezullojë atë. Çdo pezullim do të vazhdojë derisa Banka të vërë në dijeni Huamarrësin se ajo mund të tërheqë përsëri nga banka kredinë ose siç mund të paraqitet rasti, derisa Banka ta shfuqizojë ose anulojë shumën e pezulluar siç parashikohet edhe më poshtë.

Për më tepër, Banka, nëpërmjet një njoftimi me shkrim për Huamarrësin, mund të anulojë, të gjithë ose një pjesë të padisbursuar të kredisë sipas (i) dhe (ii) më sipër, subjekt i procedurës përkatëse të specifikuar në nenin 4.03 A ose nenin 10.01.

Megjithatë, Banka nuk do të mund të anulojë ose pezullojë, sipas pikës (iii) të mësipërme, çdo këst që ka qenë subjekt i një njoftimi disbursimi.

C. Kompesimi për pezullimin ose anulimin e një kësti

1. Pezullimi

Nëse, për ndonjë nga rastet e përmendura në nenin 10.01, Banka pezullon një këst të njoftuar, Huamarrësi do dëmshpërblejë Bankën në përputhje me nenin 1.05B.

2. Anulimi

Nëse Huamarrësi anulon një këst i cili ka qenë subjekt i një njoftimi disbursimi (këtu e më poshtë (këst i njoftuar), ai do të dëmshpërblejë Bankën në përputhje me nenin 4.02 B.

Nëse Banka anulon një këst të njoftuar sipas nenit 1.05 C (duke ndjekur gjashtë muaj kompesim), Huamarrësi do ta dëmshpërblejë Bankën sipas nenit 4.02 B. Nëse Banka e anulon një këst të njoftuar për shkak të ndonjë rasti të përmendur në nenin 10.01, Huamarrësi do ta dëmshpërblejë Bankën sipas nenit 10.03 A ose B. Me përjashtim të këtyre rasteve, nuk paguhet asnjë dëmshpërblim për anulimin nga ana e Bankës.

Dëmshpërblimi do të përllogaritet mbi bazat që shuma e anuluar do të gjykohet të disbursohet dhe të ripaguhet në datën e skeduar të disbursimit ose, në fazën kur disbursimi i një kësti aktualisht është shtyrë ose lënë pezull, në datën e anulimit të njoftimit.

Nëse Huamarrësi anulon pjesë të kredisë dhe jo këstin e njoftuar, nuk paguhet dëmshpërblim.

3. Përfshirja VSFR

Duke hequr paragrafët (1) dhe (2) më sipër, asnjë dëmshpërblim nuk paguhet mbi pezullimin ose anulimin e një kësti të njoftuar VSFR, përveçse kur ai bëhet nga Banka për rastet e përmendura në nenin 10.01

D. Anulimi pas skadimit të kredisë

Në çdo kohë pas afatit përfundimtar për Huamarrësin për të paraqitur një kërkesë disbursimi sipas nenit 1.02B, Banka duhet që me anë të një njoftimi që i bën Huamarrësit dhe pa detyrime nga të dy palët, të anulojë pjesë të kredisë sesa një këst të njoftuar.

1.07 Shumat e duhura sipas nenit 1

Shumat e duhura sipas neneve 1.05 dhe 1.06 do të paguhen në euro. Ato do të paguhen brenda 7 ditëve pas marrjes nga Huamarrësi të kërkesës së Bankës ose brenda një periudhe më të gjatë të specifikuar në njoftimin e kërkesës së Bankës.

Neni 2

Huaja

2.01 Shuma e huasë

Huaja (që këtu e më poshtë do të quhet “Hua”) do të përmbajë shumat e përgjithshme të disbursuara nga Banka në monedhat e disbursimit, sipas njoftimeve që bën Banka me shkrim për çdo rast disbursimi të çdo kësti.

2.02 Monedha e ripagesave

Çdo ripagesë e këstit sipas nenit 4 ose, sipas rastit, nenit 10, do të bëhet në monedhën e këstit.

2.03 Monedha e interesit dhe e detyrimeve të tjera

Interesi dhe detyrimet e tjera të pagueshme nga ana e Huamarrësit sipas neneve 3, 4 ose kur është i zbatueshëm dhe neni 10, do të llogariten dhe paguhen në përputhje me çdo këst në monedhën e këstit.

Çdo pagesë tjetër do të bëhet në monedhën e përcaktuar nga Banka duke pasur parasysh monedhën e shpenzimeve që duhen rimbursuar nëpërmjet asaj pagese.

2.04 Konfirmimi i Bankës

Pas disbursimit të çdo kësti, Banka i jep Huamarrësit një situacion të përmbledhur ku konfirmohet data e disbursimit, monedha dhe shuma, kushtet e ripagesës dhe përqindja e interesit për atë këst. Ky konfirmim do të përfshijë një tabelë amortizuese.

Neni 3

Interesi

3.01 Norma e interesit

A. Këstet me normë fikse

Huamarrësi do të paguajë interes për bilancin e papaguar të çdo kësti me normë fikse gjashtë mujore ose vjetore në prapambetje të datave përkatëse të pagesës së interesit, siç specifikohet në njoftimin e disbursimit, duke filluar me datën e parë të pagesës dhe duke ndjekur datën e disbursimit të këstit.

Interesi do të llogaritet në bazë të nenit 5.02(i) me një normë fikse. Në këtë kontratë, “Normë fikse” nënkupton përqindjen vjetore të interesit të përcaktuar nga Banka në përputhje me parimet e aplikueshme herë pas here, të vendosura nga bordet e Bankës për huatë me një normë fikse interesi, të emëruar në monedhën e këstit dhe që ka termat ekuivalente për ripagesën e kapitalit dhe pagesën e interesit

B. Këstet me përqindje të ndryshueshme (VSFR)

Huamarrësi do të paguajë interes për bilancin e papaguar të çdo kësti VSFR të VSRF (siç përcaktohet më poshtë) tremujore, gjashtëmujore ose vjetore në çdo datë të pagesës, siç specifikohet në njoftimin e disbursimit, subjekt i kufirit të normës përkatëse të Bankës Kombëtare plus 40 pikë bazë (0,40%).

Nëse kësti paguhet në ditën që nuk është ditë tremujori (ose ku një ditë tremujori nuk është ditë punë, në ditën e parë pasardhëse që është ditë pune) interesi për periudhën nga data e disbursimit deri në ditën e parë të tremujorit do të paguhet sipas normës përkatëse të Bankës Kombëtare.

Banka do t'i njoftojë normën e interesit VSFR Huamarrësit brenda 10 ditëve duke ndjekur fillimin e periudhës referuese VSRF për të cilën ajo aplikohet.

Interesi do të llogaritet në përputhje me çdo periudhë reference VSFR duke u bazuar në nenin 5.02(U)

Në këtë kontratë:

VSFR nënkupton një normë të ndryshueshme interesi, që do të thotë një normë vjetore interesi të përcaktuar nga Banka për çdo periudhë referuese VSRF në përputhje me parimet e aplikueshme herë pas here të vendosura nga bordi drejtues i Bankës për huatë e bëra me një normë të ndryshueshme interesi, që nuk është e përcaktuar duke iu referuar normës përkatëse të Bankës Kombëtare.

Ditë tremujori nënkupton çdo 15 mars, 15 qershor, 15 shtator dhe 15 dhjetor.

Periudhë referuese VSFR nënkupton çdo periudhë nga njëra ditë e tremujorit në ditën tjetër të tremujorit (nëse ose jo dita e tremujorit është ditë pagese).

3.02 Interesi për shumat e paguara

Pa paragjykim për nenin 10 dhe duke përjashtuar nenin 3.01, interesi do të rritet për çdo shumë të paguar sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, nga data respektive në datën aktuale të pagesës me një normë vjetore të barabartë me përqindjen relevante të Bankës Kombëtare + 2% (200 pikë) dhe do të paguhet në përputhje me kërkesën e Bankës. Me qëllimin e përcaktuar të përqindjes relevante të Bankës Kombëtare në lidhje me nenin 3.02, periudhat përkatëse brenda kuptimit të skedulit B do të jenë periudha në vazhdimësi të një muaji, që nis në datën e bërjes së pagesës.

Megjithatë, interesi për një këst me normë fikse do të detyrohet në një përqindje vjetore që është shuma e përqindjes së përcaktuar në nenin 3.01A + 0.25% (25 pikë) nëse kjo përqindje vjetore tejkalohet, për ndonjë periudhë të përcaktuar relevante, përqindja specifikohet në paragrafin e mëparshëm.

Nëse shuma e paguar është në monedhë tjetër dhe jo në atë të huasë, do të aplikohet përqindja e mëposhtme për çdo vit, pra norma përkatëse e Bankës Kombëtare që zakonisht mbahet nga Banka për transaksione në atë monedhë +2% (200 pikë), e llogaritur në përputhje me praktikën e tregut për një përqindje të tillë.

Neni 4 Ripagesa

4.01 Ripagesa normale

A. Me këste

Huamarrësi do të ripaguajë çdo këst me këste gjashtëmujore ose vjetore në datat e specifikuara në njoftimin përkatës për disbursim (çdo datë ripagese do të jetë datë pagese për këtë këst) në përputhje me termat e tabelës amortizuese të specifikuar në deklaratën përkatëse të përmendur në nenin 2.04.

Çdo tabelë amortizimi do të hartohet mbi bazat që:

i) ripagesa e një kësti do të bëhet (a) në rastin e një kësti me normë fikse ose (i) në baza konstante vjetore, kështu që shuma e arritur e principialit dhe interesi i paguar sipas këstit duhet të jetë pothuajse i njëjtë në çdo datë ripagese ose (ii) me këste të barabarta të principialit dhe (b) në rastin e një kësti VSFR, në këste të barabarta të principialit;

ii) data e parë e ripagesës së çdo kësti do të jetë një datë pagese që bie jo më vonë se data e parë e pagesës duke ndjekur menjëherë 5 vite nga data e disbursimit të këstit dhe data e fundit e ripagesës nuk duhet të bjerë brenda katër viteve, por jo më vonë se 15 vjet nga data e disbursimit.

B. Përcaktimi i datës së maturimit

Data e fundit dhe e vetme e ripagesës së një kësti të specifikuar sipas nenit 4.01A(ii) këtu dhe më poshtë do të referohet si data e maturimit.

4.02 Parapagesë vullnetare

A. Opsioni i parapagesës

Subjekt i neneve 4.02B dhe 4.04, Huamarrësi mund të parapaguajë të gjithë ose pjesë të çdo kësti së bashku me interesin e rritur, duke njoftuar me shkrim një muaj përpara (këtu e më poshtë do të njihet si njoftim parapagesë) ku përcaktohet shuma për t'u parapaguar (Shuma e parapaguar) dhe data në të cilën Huamarrësi propozon ta bëjë të vlefshme parapagesën (Data e parapagesës) që do të jetë një datë pagese për atë këst.

B. Dëmshpërblimi i parapagesës

1) Kësti me interes fiks

Në përputhje me çdo shumë të parapaguar të një kësti me interes fiks, Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës në datën e parapagesës një dëmshpërblim të barabartë me vlerën aktuale (ashtu si dhe data e ripagesës) të tepricës, nëse ka ndonjë, të:

i) interesit, i cili do të rritet pas kësaj për shumën e parapaguar për periudhën nga data e ripagesës deri në datën e maturimit, nëse ajo nuk është parapaguar, mbi

ii) interesit që kështu do të rritet në këtë periudhë, nëse ajo është llogaritur sipas përqindjes së BERZH-it (siç përcaktohet më poshtë), që bëhet efektive një muaj para datës së parapagesës me më pak se 15 pikë.

Në këtë kontratë interesi i rirreshtimit nënkupton interesin fiks të aplikueshëm për një hua të bërë një muaj para datës së parapagesës dhe që ka të njëjtat terma për pagesat e interesit dhe të njëjtin profil ripagese për datën e maturimit sikurse dhe shumën e parapagesës. Vlera aktuale e thënë do të llogaritet me një përqindje të ulur të barabartë me interesin e rirreshtimit BEI që aplikohet për çdo shumë pagese përkatëse.

2. Kësti i ndryshueshëm VSFR

Huamarrësi mund të parapaguajë një këst VSFR pa dëmshpërblim për ndonjë datë pagese përkatëse.

C. Mekanizmat e parapagesës

Banka duhet të njoftojë Huamarrësin, jo më vonë se 15 ditë para datës së parapagesës, për shumën e parapaguar, të interesit të paguar dhe, në rastin e parapagesës së një kësti me interes fiks, dëmshpërblimit të paguar sipas nenit 4.02B ose, siç mund të jetë rasti, mund të mos jetë paguar dëmshpërblim.

Jo më vonë se afati i rënë dakord (siç përcaktohet më poshtë), Huamarrësi do të njoftojë Bankën ose:

i) që ai konfirmon njoftimin e parapagesës sipas termave të specifikuara nga Banka; ose

ii) që ai e tërheq njoftimin e parapagesës.

Nëse Huamarrësi konfirmon sipas (i), ajo do të ndikojë parapagesën. Nëse Huamarrësi tërheq njoftimin e parapagesës ose nuk arrin ta konfirmojë në kohën e duhur, ajo mund të mos ketë ndikim të parapagesa. Me përjashtim të asaj që u tha më sipër, njoftimi i parapagesës do të jetë i detyrueshëm dhe i paravokueshëm.

Huamarrësi do të shoqërojë parapagimin duke paguar interesin e rritur dhe dëmshpërblimin, nëse ka ndonjë, në kohën e duhur të shumës së parapaguar.

Për qëllimet e këtij neni 4.02C afati i rënë dakord, për një njoftim është:

i) ora 17h 00 e Luksemburgut në ditën e dorëzimit, nëse njoftimi dorëzohet në një ditë pune të Luksenburgut; ose

ii) ora 17h 00 në ditën tjetër, e cila është ditë pune në Luksemburg nëse njoftimi dorëzohet pas orës 12 të Luksemburgut të po kësaj dite ose në një ditë, e cila nuk është ditë pune në Luksemburg.

4.03 Parapagesë e detyruar

A. Terreni për parapagesa

Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht pjesërisht ose të gjithë ndonjë hua tjetër, ose ndonjë borxh tjetër financiar ose kredi që fillimisht i është dhënë për një periudhë më të gjatë se pesë vjet, (këtu e më poshtë termi hua) përkundrejt pagesave të huasë që kanë një periudhë të njëjtë me periudhat e mosmbarimit të afatit të huasë së parapaguar, Banka mundet, që me anë të njoftimit të Huamarrësit, të anulojë kredinë ose të kërkojë parapagesë të kësaj huaje në përpjesëtim të tillë që

shuma e parapaguar e huasë mbart shumat totale të papaguara për të gjitha këto hua.

Banka do t'ia adresojë njoftimin e saj Huamarrësit brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit sipas nenit 8.02(iii)(f).

B. Mekanikat e parapagesës

Çdo shumë e kërkuar nga Banka sipas nenit 4.03A, së bashku me interesin e rritur dhe një shumë dëmshpërblimi, nëse ka, e llogaritur sipas nenit 4.03C do të paguhet, në datën e përcaktuar nga Banka, datë:

i) ku parapagesa do të bëhet sipas paragrafit (1) të nenit 4.03A, jo para datës së parapagesës të periudhës së huasë; dhe

ii) ku parapagesa bëhet sipas ndonjë pike tjetër të nenit 4.03A, duhet të bëhet jo më pak se tridhjetë ditë nga data e kërkesës së Bankës.

C. Dëmshpërblimi i parapaguar

Nëse, për më tepër, sipas dispozitave të nenit 4.03 Huamarrësi parapaguan një këst në datë tjetër dhe jo në ditën përkatëse të pagesës, Huamarrësi do të dëmshpërblejë Bankën me një shumë të tillë që Banka do të vërtetojë se kërkohet për ta kompensuar atë për marrjen e fondeve jo në datën e përcaktuar të pagesës.

4.04 Aplikimi për parapagesa të pjesshme

Në rast se Huamarrësi e parapaguan pjesërisht këstin, shuma e parapaguar aplikohet me ulje prorata për çdo këst të papaguar.

Nëse Banka kërkon një parapagesë të pjesshme të huasë, Huamarrësi, në përputhje me kërkesën, mundet që, me anë të njoftimit të Bankës të dorëzuar brenda 5 ditëve-pune Luksemburgu me marrjen e kërkesës së bankës, të zgjedhi këstet dhe shumat përkatëse që përbëjnë shumat e duhura që do të parapagohen. Nëse Huamarrësi nuk zgjedh, Banka do ta bëjë këtë.

**Neni 5
Pagesat**

5.01 Datat e pagesës

Në këtë kontratë:

Data e pagesës do të thotë:

i) për një këst me interes fikse çdo 5 janar dhe 5 korrik; dhe

ii) për një këst të ndryshueshëm VSFR, çdo ditë tremujori deri në datën e maturimit, veçse, në rast se kjo ditë nuk është një ditë pune, ajo nënkupton ditën përkatëse pasardhëse të punës.

Ditë relevante biznesi nënkupton:

i) Për Europën, një ditë në të cilën operon sistemi i pagesave (TARGET);

ii) Për çdo monedhë tjetër, një ditë në të cilën bankat janë hapur për biznes në qendrat kryesore financiare për këmbimet monetare.

5.02 Numërimi i ditës së konvertimit

Çdo shumë që lind për interesa, dëmshpërblime, ose tarifa të tjera nga Huamarrësi sipas kësaj kontrate dhe të llogaritura për një pjesë viti, do të përcaktohen sipas konvertimeve respektive të mëposhtme:

i) për një këst me pëqindje fikse, mbi bazën e një viti me 360 ditë dhe një muaji me 30 ditë;

ii) për një këst VSFR, 360 ditë dhe një numër ditësh të kaluara.

5.02 Vendi dhe koha e pagimit

Të gjitha shumat, përveç atyre të interesit, kompesimit dhe principialit do të paguhën brenda 7 ditëve pas marrjes së kërkesës së Bankës nga ana e Huamarrësit.

Çdo shumë e pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj kontrate do të paguhet në llogarinë që banka ka vënë në dijeni Huamarrësin. Banka do të përcaktojë llogarinë jo më pak se pesëmbëdhjetë ditë para datës së pagesës së parë nga Huamarrësi dhe do të njoftojë për çdo ndryshim të llogarisë në jo më pak se pesëmbëdhjetë ditë para datës të pagesës së parë që i bëhet ndryshimi. Kjo periudhë njoftimi nuk aplikohet në rast pagese sipas nenit 10.

Shuma e duhur nga Huamarrësi do të gjykohet e paguar kur Banka ta marrë atë.

Neni 6

Sipërmarrjet e Huamarrësit

6.01 Përdorimi i huasë dhe fondeve të tjera

Huamarrësi do të përdorë shumat e huasë ekskluzivisht për zbatimin e projektit.

Huamarrësi do të sigurojë dhe fonde të tjera të përshkruara në deklamimin 3 dhe do të sigurojë që ato do të shpenzohen për financimin e projektit.

6.02 Përfundimi i projektit

Huamarrësi angazhohet të realizojë projektin në përputhje me përshkrimin teknik, dhe sipas ndryshimeve që Banka mund të aprovojë kohë pas kohe, dhe ta përfundojë atë në datën finale të specifikuar aty.

6.03 Kostoja e rritur e projektit

Nëse kostoja e projektit e kalon shifrën e vlerësuar të deklamimit 2, Huamarrësi do të marrë shumën për të financuar koston e tejkaluar pa mbështetjen e Bankës, në mënyrë që të realizojë projektin në përputhje me përshkrimin teknik.

6.04 Procedurat e tenderit

Huamarrësi merr përsipër blerjen e pajisjeve, prokurimin e shërbimeve dhe porositjen e punimeve për projektin me tender të hapur ndërkombëtar për të gjitha vendet, ose me procedura të tjera prokurimi të pranueshme për Bankën, sa kohë që është e mundur dhe e përshtatshme, me politikat e tij siç përshkruhen në guidën e prokurimeve të Komunitetit Europian, në veçanti në seksionet 3.2.3, siç është publikuar në datën e kësaj kontrate.

6.05 Menaxhimi i projektit

Huamarrësi do të ngrejë sipas termave të referencës të pranueshëm për Bankën, një njësi për menaxhimin e projektit me një staf të përshtatshëm gjatë gjithë kohës së zbatimit të të gjitha fazave të projektit. Kjo njësi do të jetë përgjegjëse për kordinimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha aspekteve të zbatimit të projektit.

6.06 Siguracioni

Huamarrësi do të sigurojë në mënyrë të përshtatshme të gjitha punimet dhe pasuritë që janë pjesë të projektit me kompani sigurimi të klasit të parë.

6.07 Mirëmbajtja

Huamarrësi do të mirëmbajë, riparojë dhe rinovojë të gjithë pasurinë që është pjesë e projektit siç kërkohet për ta mbajtur në kushte të mira pune.

6.08 Ambienti

Huamarrësi do të zbatojë dhe operojë projektin në përputhje me ligjet e Bashkimit Europian dhe të Shqipërisë, të cilat si objektiv kryesor kanë ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit, dhe përfshin dispozitat legjislative që marrin parasysh marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me ambientin; për këtë qëllim mjedis nënkupton si më poshtë, përderisa ato ndikojnë te qeniet e gjalla:

a) faunën dhe florën;

b) tokën, ujin, ajrin, klimën dhe peizazhin;

c) godinat dhe trashëgiminë kulturore;

dhe përpara fillimit të vënies në punë të TEC-it, i cili është dhe objekti i projektit, do të bëjë një plan menaxhimi të ambientit me terma në përputhje me këto dispozita dhe ta zbatojë atë në mënyrë kohore.

6.09 Asetet e projektit

Huamarrësi do të ketë, përveç rastit kur Banka nuk e pranon me shkrim, ose në emër të saj ose në emër të një filiali të zotëruar plotësisht prej saj, në varësi dhe pronësi asetet e projektit, zëvendësimin dhe rinovimin e këtyre aseteve dhe ta mbajë projektin në funksionim të vazhdueshëm sipas qëllimit të tij fillestar, Banka mund të mos japë pëlqimin e saj vetëm nëse kur veprimet e propozuara mund të: (1) paragjykojnë interesat e Bankës si dhënës i huasë ose të dështojë në qëllimin ekonomik të huasë ose (2) dhe kur projekti humb legjitimitetin e financimit nga ana e Bankës sipas nenit 267 të Traktatit të Romës.

6.10 Kontratat e BERZH-it

Huamarrësi merr përsipër që t'i realizojë pikë për pikë kontratat e përfshira në marrëveshjen e huasë të lidhura me BERZH-in për qëllimin e financimit të këtij projekti, dhe t'i japë Bankës informacionin për përmbajtjen dhe herë pas here dhe ecurinë e kërkesave të kësaj Marrëveshjeje.

6.11 Krijimi i një filiali ndihmës

Huamarrësi do të krijojë një filial të vetin ndihmës për zotërimin dhe vënien në punë të projektit deri në 31 dhjetor 2004.

6.12 Fondi i barazimit

Huamarrësi do të vendosë një fond barazimi deri më 31 dhjetor 2004 dhe ta ruajë atë siç kërkohet në planveprimin.

6.13 Planveprimi i sektorit energjetik

Huamarrësi do të zbatojë për vitet 2004 deri në 2006 dhe për vitet e ardhshme një planveprimi dyvjeçar dhe do të bëjë të pamundurën për arritjen e objektivave të planveprimit për zvogëlimin e humbjeve në transmetim dhe shpërndarje, dhe për përmirësimin e arkëtimeve.

6.14 Zgjidhja e aseteve

Kur zgjidhja ka një efekt material të ndryshëm për të arritur objektivat e kontratës, Huamarrësi merr përsipër të mos shesë të gjithë ose pjesët kryesore të biznesit të tij, ndërmarrje ose asete, pa miratimin me shkrim të Bankës.

Për qëllimet e këtij neni 6.06 zgjidhja, përfshin çdo veprim që ka të bëjë me shitjen, transferimin, huanë, qiranë ose detyrat.

6.15 Angazhimi i integritetit

Huamarrësi garanton dhe merr përsipër që ai nuk ka kryer, dhe asnjë person sipas njohurive të tij nuk ka kryer aktet e mëposhtme dhe se ai nuk do të kryejë, dhe asnjë person, me pëlqimin e tij apo vënien e tij në dijeni, nuk do të kryejë veprime të tilla, që do të thotë:

i) ofrimin, dhënien, marrjen ose kërkimin e favoreve për të ndikuar veprimin e ndonjë personi që mban një post apo funksion publik, ose drejtorin ose punonjësën e një organi publik ose ndërmarrje publike ose drejtorin, ose ndonjë zyrtar të ndonjë organizate publike ndërkombëtare në lidhje me procesin e prokurimit ose në zbatimin e ndonjë kontrate në lidhje me këto elemente të projektit të përshkruara në përshkrimin teknik; ose

ii) ndonjë veprim i cili ndikon pa vend ose synon të ketë influencë në procesin e prokurimit ose në zbatimin e projektit në dëm të Huamarrësit, duke përfshirë përplasjen ndërmjet tenderuesve.

Për këtë qëllim, njohja e çdo anëtari të bordit të drejtorëve të Huamarrësit ose të filialit ndihmës të përmendur në nenin 6.11 ose të ndonjë anëtari të njësisë së zbatimit të projektit, ose të zyrtarit të përmendur në nenin 12.01 do të gjykohen nga Huamarrësi. Huamarrësi merr përsipër të informojë Bankën, nëse ai është i vetëdijshëm për ndonjë fakt ose informacion që të sjell ndërmend kryerjen e një veprimi të tillë.

Neni 7

Siguracioni

7.01 Garancia dhe dëmshpërblimi

Detyrimet e Bankës këtu dhe më poshtë kushtëzohen me ekzekutimin dhe me dorëzimin e garancisë në bankë.

7.02 Siguracioni negativ

Për aq kohë sa një pjesë e huasë mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose lejojë të ketë një interes sigurimi, ose, në përputhje me bizneset e tij aktuale apo të ardhme, të marrë përsipër asetet ose të ardhurat (duke përfshirë ndonjë kapital të panevojshëm). Për këtë qëllim interesi i sigurimit nënkupon çdo rast hipotekë, siguracion, pengesë si garanci pagese, tarife, detyre, interesin e hipotekës apo të sigurisë, ose ndonjë marrëveshje ose rregullim tjetër që ka efekt në sigurinë e diskutuar.

Huamarrësi paraqet se në datën e kësaj kontrate nuk ekzistojnë interesa sigurie mbi asetet e tij.

Neni 8 Informacion dhe vizita

8.01 Informacion lidhur me projektin

Huamarrësi:

i) do t'i dorëzojë Bankës:

i) Informacionin në përmbajtje dhe në formë, në kohën e specifikuar në skedulin A.2 ose pëndryshe siç është rënë dakord herë pas here ndërmjet palëve të kësaj kontrate, dhe (ii) dokumente dhe informacione të mëtejshme që kanë lidhje me financimin, zbatimin, vënien në punë dhe impaktin ambjental të projektit ashtu siç mund ta kërkojë Banka.

ii) Të ruajë, në një vend, për inspektim gjatë gjashtë viteve nga përfundimi i çdo kontrate të financuar nga huaja, termat e plotë të vetë kontratës, si dhe të gjitha dokumentet që kanë lidhje me procesin e prokurimit dhe me zbatimin e kontratës dhe (b) të sigurojë që banka mund të inspektojë dokumentet kontraktuale që kontraktori është i detyruar t'i ruajë sipas kontratës furnizuese.

iii) T'i dërgojë Bankës pa vonesë për aprovim çdo ndryshim material në planet e përgjithshme, afatet, planet financiare ose programet e shpenzimeve të projektit, sipas ekspozimeve që i bëhen Bankës para firmosjes së kësaj kontrate.

iv) Të njoftojë Bankën për çdo fakt apo ngjarje të ditur nga Huamarrësi, të cilat në mënyrë esenciale mund të paragjykojnë apo ndikojnë në kushtet e zbatimit apo operimit të projektit.

8.02 Informacion lidhur me Huamarrësin

Huamarrësi:

i) Do t'i japë Bankës:

a) çdo vit, brenda një muaji pas botimit të tyre, një kopje të raportit vjetor, bilancit, llogarisë humbje/fitim dhe raportin e auditorit;

b) herë pas here, informacion të mëtejshëm për gjendjen e përgjithshme financiare, siç mund ta kërkojë Banka;

ii) Të sigurojë se regjistrimi i llogarive pasqyron plotësisht veprimet në lidhje me financimin, zbatimin dhe operimin e projektit; dhe

iii) Të informojë Bankën:

a) menjëherë për çdo ndryshim material në statut, pas datës së kësaj kontrate;

b) menjëherë për ndonjë arsye apo fakt që e detyron atë të parapaguajë çdo borxh tjetër financiar;

c) menjëherë për ndonjë proces gjyqësor që ka nisur ose që e rrezikon atë në lidhje me çështjet e mjedisit që ndikojnë në projekt;

d) menjëherë për çdo synim nga ana e vet për të dhënë ndonjë siguracion lidhur me asetet e veta në favor të një pale të tretë;

e) menjëherë për ndonjë nga vendimet e marra prej saj për të bërë një parapagesë të një huaje siç referohet në nenin 4.03A(1);

f) menjëherë për synimin e tij ose të synimeve të të gjitha filialeve të tij ndihmëse të heqë dorë nga pronësia e ndonjë pjese të rëndësishme të projektit;

g) për situatën e mirë ose veprimet, të cilat kërkojnë miratim nga Banka sipas nenit 6.14; ose

h) të informojë Bankën për ndonjë fakt apo ngjarje që ndalon plotësimin e detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj kontrate.

8.03 Vizitat

Huamarrësi do të lejojë personat e caktuar nga Banka për të parë vendet, instalimet dhe punimet në projekt për të bërë kontrollet që dëshirojnë, Huamarrësi do t'u ofrojë dhe japë të gjithë ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.

8.04 Hetimet dhe informacioni

Huamarrësi merr përsipër:

i) të ndërmarrë veprime të tilla që i kërkon Banka në mënyrë të arsyeshme për të hetuar dhe/ose për të zgjidhur çdo veprim të supozuar ose të dyshuar për natyrën e përshkruar në nenin 6.15;

- ii) të informojë Bankën për masat e marra për dëmet nga personat përgjegjës për humbjet që mund të rezultojnë nga një veprim i tillë; dhe
- iii) të lehtësojë çdo hetim që Banka mund të bëjë në lidhje me këtë akt.

Neni 9

Detyrime dhe shpenzime

9.01 Taksat, detyrimet dhe pagesa faturash

Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat, detyrimet, faturat dhe shuma të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë detyrimin e pullës, taksën e regjistrimit që dalin nga zbatimi i kësaj kontrate apo ndonjë dokumenti të ngjashëm, krijuar për ndonjë siguracion të huasë.

Huamarrësi do të paguajë të gjithë principalin, interesin, dëmshpërblimin dhe shuma të tjera sipas kësaj kontrate bruto pa heqjen e ndonjë detyrimi kombëtar apo vendas, me kusht që nëse Huamarrësi është i detyruar prej ligjit për një zbritje të tillë, ai do t'ia rrisë pagesën Bankës, në mënyrë të tillë që pas zbritjes shuma neto e marrë nga Banka të jetë e barabartë me shumën e duhur.

9.02 Detyrime të tjera

Huamarrësi do të mbartë çdo detyrim apo shpenzim. Duke përfshirë detyrime profesionale, bankare, transferte apo këmbimi të dalë nga përgatitja dhe zbatimi i kësaj kontrate ose të ndonjë dokumenti tjetër të ngjashëm, duke përfshirë çdo ndryshim këtu.

Neni 10

Parapagesë në rast mospagese

10.01 E drejta për të kërkuar ripagesë

Huamarrësi do të ripaguajë huanë ose pjesë të saj, së bashku me interesin e rritur, direkt pas kërkesës me shkrim që bën Banka në përputhje me kushtet e mëposhtme:

A. Kërkesë e menjëhershme

Banka mund ta bëjë një kërkesë të tillë menjëherë:

i) Nëse ndonjë informacion ose dokument që i jepet Bankës nga ose në emër të Huamarrësit lidhur me negocimin e kësaj kontrate ose gjatë kohëzgjatjes së saj vërteton se është parë i pasaktë në ndonjë material të veçantë;

ii) Nëse Huamarrësi nuk bën ripagesën në datën e caktuar për pjesë të huasë, ai do të paguajë interesin ose do të bëjë ndonjë pagesë tjetër sipas kushteve të përcaktuara këtu;

iii) Nëse Huamarrësi nuk paguan ndonjë detyrim financiar dhe nëse pas ndonjë mospagesë në të, Huamarrësit i kërkohet duke ndjekur mbarimin e periudhës së aplikueshme kontraktuale ose ai do të parapaguajë huanë tjetër, ose të paguajë tërësisht para maturitetit çdo mospagesë dalë nga transaksioni financiar, i cili është një shumë totale principali më shumë se 5 milionë euro ose i barasvlefshëm;

iv) Nëse Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet e tij ose kërkon të bëjë një marrëveshje me kreditorët e tij;

v) Nëse Huamarrësi ndalon së qeni pronar nga Republika e Shqipërisë;

vi) Në rast të ndonjë urdhëri apo rezolute për mbylljen e aktivitetit të Huamarrësit ose nëse Huamarrësi ndërmerr hapa në zvogëlimin e dukshëm të kapitalit të tij, deklaron falimentim apo ndërpret aktivitetin tërësisht apo pjesërisht të biznesit, regjistrohet në kursin e rindërtimit, të shkrirjes, riorganizmit, bashkimit ose konsolidimit të lejuar më parë nga Banka;

vii) Nëse (a) një mbajtës i garancisë bëhet zotërues i, ose një marrës, likuidues, administrator, marrës administrues, ose caktohet një zyrtar i njëjtë, nga një gjykatë e një juridiksioni kompetent ose nga çdo autoritet kompetent administrativ i ose mbi, pjesë të biznesit ose aseteve të Huamarrësit ose çdo pronësie që përbën pjesë të projektit; (b) në rast rreziku, zbatimi, sekuestrimi ose procese të tjera për vendosjen e taksave ose të imponimit të tyre në pronën e huamarrësit ose çdo pronësi që përbën pjesë të projektit dhe nuk shkarkohet nga detyrimet ose të qëndrojnë brenda 14 ditëve; ose (c) nëse ndodh ndonjë rast, i cili mund të vërë në rrezik shërbimin e huasë ose anashjelltas ka efekt në ndonjë siguracion të dhënë; ose

viii) Nëse ndodh ndonjë ngjarje materiale e anasjelltë në lidhje me Huamarrësin.

B. Kërkesa pas njoftimit për zhdëmtim

Banka mund të bëjë një kërkesë të tillë, për çështjet që nuk janë zhdëmtuar brenda një periudhe të arsyeshme kohe të specifikuar në njoftimin e servitur Huamarrësit nga Banka.

i) Nëse Huamarrësi nuk plotëson ndonjë detyrim material të kontratës, jo detyrim që përmendet në nenin 10.01A(ii); ose

ii) Nëse ndonjë fakt ose rrethanë e përmendur në deklamimet ndryshon thelbësisht dhe nuk ruhet thelbësisht, dhe nëse ndryshimi paragjykon interesat e Bankës si dhënësi i huasë ose ndikon në mënyrë të ndërsjellë në zbatimin dhe operimin e projektit.

10.02 Të drejta të tjera me ligj

Neni 10.01 nuk do të kufizojë të drejta të tjera të Bankës me ligj për të kërkuar parapagesë të huasë.

10.03 Dëmshpërblimi

A. Këstet me përqindje fikse

Në rast kërkesë për parapagesë sipas nenit 10.01 në lidhje me këstin e përqindjes fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një shumë të llogaritur në përputhje me nenin 4.02B mbi çdo shumë që është e paguar: Një shumë e tillë do të rritet nga data e pagesës së përcaktuar në njoftimin e kërkesës së Bankës dhe do të llogaritet mbi bazën që parapagimi do të jetë efektiv në datën e specifikuar.

B. Këstet me interes të ndryshueshëm VSFR

Në rast kërkesë për parapagesë sipas nenit 10.01 në përputhje me këstin VSFR, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një shumë të barabartë me vlerën aktuale 0.15% (15 pikë) në vit e llogaritur dhe e rritur bazuar në shumën që është përcaktuar të paguhet në të njëjtën mënyrë siç mund të ishte llogaritur interesi dhe mund të jetë rritur, nëse kjo shumë do të ketë mbetur e prapambetur sipas skedulit origjinal të amortizimit të këstit.

Kjo vlerë aktuale do të përcaktohet duke përdorur një përqindje zbritjeje, të aplikuar për çdo datë pagese përkatëse. Përqindja e zbritur do të jetë përqindje fikse për huanë e bërë një muaj para datës së parapagimit dhe që kanë të njëjtat kushte për pagesat e interesit dhe të njëjta kushte për datën e maturimit sikurse dhe shumën që do të parapaguhet.

C. Të përgjithshme

Shumat e paguara nga Huamarrësi sipas këtij neni 10.03 do të paguhet në datën e parapagesës të specifikuar në kërkesën e Bankës.

10.04 Asnjë heqje e së drejtës

Asnjë mosrealizim apo vonesë nga Banka në ushtrimimin e të drejtave sipas nenit 10 do të kuptohet si heqje e kësaj të drejte.

10.04 Aplikimi i shumave të marra

Shumat e marra pas një kërkesë të bërë nga Banka sipas nenit 10 do të aplikohen së pari në pagesën shpenzimeve, interesit dhe dëmshpërblimit, dhe së dyti në zvogëlimin e kësteve të papaguara në kundërshtim me urdhërin e maturitetit. Ato do të aplikohen ndërmjet kësteve me dekret të Bankës.

Neni 11

Ligji dhe juridiksioni

11.01 Ligji

Kjo kontratë do të udhëhiqet nga ligjet e Granduchy të Luxembourgut.

11.02 Juridiksioni

Palët këtu dhe më poshtë paraqesin mosmarrëveshjet në gjyqin e drejtësisë së Komunitetit European.

11.02 Evidencë e shumave përkatëse

Çdo veprim ligjor që është rezultat i kësaj kontrate, vërteton çdo shumë që i duhet paguar Bankës në përputhje me këtë kontratë duke dhënë së pari evidencë për një shumë të tillë.

Neni 12
Klauzolat përfundimtare

12.01 Nëpunësi përgjegjës

Derisa Huamarrësi t'a specifikojë me shkrim Bankës, drejtori i investimeve të Huamarrësit do të jetë përgjegjës për kontaktet me Bankën për qëllimet e nenit 6.15.

12.02 Njoftimet

Njoftimet dhe komunikimet e tjera që jepen më poshtë dhe që u adresohen secilës palë të kësaj kontrate, do të dërgohen në adresat e përmendura më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër, e cila iu është bërë e ditur më parë secilës palë, me përjashtim të njoftimeve për Huamarrësin lidhur me procese gjyqësore, për pezullim apo mosvazhdim, do të dërgohen në adresën (2) si më poshtë ku Huamarrësi përzgjedh rezidencën.

Për Bankën: Attention: Credit Risk Department
100 boulevard Konrad Adenauer
L - 2950 Luxembourg-Kirchberg

Për Huamarrësin:

1) Blloku "Vasil Shanto"

Tiranë — Albania

2) Misioni i Republikës së Shqipërisë në Komunitetin European
rue Tenbosch 30
B- 1000 Brussels

Derisa Huamarrësi t'a specifikojë me shkrim Bankës, drejtori i investimeve të Huamarrësit do të jetë përgjegjës për kontaktet me Bankën për qëllimet e nenit 6.15.

12.03 Forma e njoftimit

Njoftimet dhe komunikimet e tjera për periudha të caktuara në këtë kontratë, ose periudha të caktuara të cilat janë të detyrueshme për të adresuarin, do të dërgohen me dorë, letra të regjistruara, telegrame, telex ose mjete të tjera transmetimi, të cilat vërtetohen se janë marrë nga marrësi. Data e regjistrimit, ose sipas rastit, data e vendosur në marrjen se transmetimit është përfundimtare për përcaktimin e periudhës.

12.04 Deklamime, skedulet dhe anekse

Deklamimet dhe skedulet e mëposhtme janë pjesë e kësaj kontrate;

Skeduli A. Përshkrimi teknik dhe detyrat e informimit

Skeduli B. Përkufizimi i EUR

Skeduli C.1 Certifikata e Huamarrësit

Skeduli C.2 Forma e kërkesës së disbursimit

Skeduli D. Konvertimi i këstit nga VSFR në fiks

Bashkëngjitur janë:

Aneksi I Rezoluta e Bordit të Drejtorëve të Huamarrësit dhe autorizimi i nënshkruesit.

Aneksi II Lista e lejeve dhe e licencave për projektin.

Dëshmojmë se për sa thuhet, palët e nënshkruajnë këtë kontratë në katër kopje origjinale në gjuhën angleze, të nënshkruar nga z. Andis Harasani dhe z. Roderick Dunnet në çdo faqe të kësaj kontrate në emër të palëve respektive.

29 shtator 2004

Firmosur në emër të
Bankës Europiane të Investimeve
G. Genuardi
Zv/President

Firmosur në emër të
Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.
A. Harasani
Drejtore i Përgjithshëm

A.1 PËRSHKRIMI TEKNIK

A. Projekti

Projekti përfshin studimet, projektimin, prokurimet, zbatimin, komisionimin (duke përfshirë pranimin e testeve) dhe operimin e TEC-it me cikël të kombinuar në një fushë të gjelbër me një sipërfaqe prej 6 hektarë, rreth 6 km në veri të Vlorës, me një kapacitet prej 85 deri në 135 MW; në fillim do të përdoret vaj ti distiluar me përqindje të ulët sulfuri, por projekti do të projektohet që të lejojë përdorimin e gazit natyral menjëherë sapo gazi do të jetë i disponueshëm në Shqipëri.

Projektimi do të jetë ose me 1 mbi 1 konfigurim të ciklit të kombinuar (një turbinë me djegie të brendshme, një gjenerator nxehtësie me avull dhe një turbinë avulli) ose 2 mbi 1 konfigurim (dy turbina me djegie të brendshme, dy gjeneratorë nxehtësie me avull dhe dy turbina avulli) të bazuara në një përshtatje të një turbine shumëgypëshe. Vepra do të vendoset në një ndërtesë me një vinç të lartë. Pjesët e tjera përbërëse janë:

Punimet civile, pirgjet e shkarkuara, gjeneratorët e energjisë, transformatorët, stacioni i seleksionimit, depozituesit e lëndëve djegëse për konsumim të përditshëm dhe një sistem ftohës uji, sistemi i mbrojtjes nga zjarri, sistemi i kontrollit të shpërndarjes, nxehtësia, ventilimi, kondicionimi, instrumentet, telekomunikimi, ndërtesa e administratës etj.

Përveç kësaj nevoja e përtëritjes së terminalit ekzistues të depozitimit të vajit dhe linja e tubacioneve (rreth 7,5 km) dhe ndërtimi i një qarku të dyfishtë transmissi 220 kV të një linje 7 km dhe lidhja me nënstacionin e planifikuar të Babiçës.

Asistenca teknike dhe trajnimi përfshin menaxhimin e projektit, formimin e një filiali (të mjeteve speciale) për të zotëruar dhe vënë në punë TEC-in, parapërgatitjen e një marrëveshje për blerjen e energjisë, asistencën për sigurimin e shërbimeve të operatorit për periudhën fillestare, ekzaminimin e opsioneve për furnizimin me gaz natyral dhe zbatimin e studimeve të kërkuara nga plani i menaxhimit të ambientit dhe trajnime të tjera në menaxhimin e prokurimeve dhe të ambientit.

B. Përfundimi

Projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2007.

A.2 Detyra informuese sipas nenit 8.01 (i)

1. Informimi për zbatimin e projektit

Një herë në 3 muaj livruesi do të informojë Bankën me shkrim rreth gjendjes së projektit. Ky informacion do të fokusohet në pikat me të rëndësishme të projektit, në progresin e projektit duke përfshirë ndryshimet e mëdha (nëse ka ndonjë) nga plani origjinal, dhe masat mbrojtëse të mjedisit, prokurimet dhe gjendjen e buxhetit, dhe të shikojë më përpara për periudhën tjetër duke bërë një listë të problemeve më të mëdha që do të përballohen nëse ka ndonjë.

2. Informimi në fund të punimeve dhe operimi në vitin e parë

Livruesi do të sigurojë një raport për përfundimin e projektit, i cili do t'i paraqitet Bankës deri më 31 tetor 2008 (15 muaj pas përfundimit të projektit), i cili duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Një përshkrim të shkurtër teknik të punimeve të kryera duke dhënë në mënyrë të detajuar ndryshimet, nëse ka ndonjë, nga përshkrimi teknik që i është bashkëngjitur kontratës financiare.

- Datën e përfundimit të projektit, duke treguar arsyet e vonësës, nëse ka ndonjë.

- Detajet e kostos së përmbysur së projektit, duke treguar arsyet për ndonjë ndryshim të rëndësishëm.

- Punësimi i krijuar nga projekti së bashku dhe me punët e përkohshme gjatë ndërtimit të projektit dhe pozicionet e reja të përhershme të punës.

- Ndryshimet e tregut ose të mjedisit ekonomik.

- Ndryshimet në impaktin e ambientit të skemave të projektit.

- Ndonjë koment tjetër në lidhje me zbatimin e projektit, të cilin livruesi e konsideron të rëndësishëm për t'u përmendur.

SKEDULI B

Përkufizimi i EURIBOR-it

1. “Eurobori” nënkupton:

i) Në përputhje me periudhën përkatëse, që përfshin një periudhë referuese VSFR ose ndonjë periudhë tjetër kohe për një muaj ose më shumë, përqindja e interesit për depozitat në euro për një kufi që është numri i të gjithë muajve që i korrespondojnë kohëzgjatjes së kësaj periudhe; dhe

ii) Sipas një periudhe përkatëse më pak se 1 muaj, përqindja e interesit për depozitat në euro për një periudhë prej 1 muaji (periudha për të cilën përqindja e marrë këtu e më poshtë quhet “Periudha përfaqësuese”) siç publikohet në orën 11 sipas orës së Brukselit ose në një kohë të mëvonë të pranueshme nga Banka në ditën (“Data e rivendosur”) e cila bie dy ditë përpara ditës së parë të periudhës përkatëse në faqen e Rojterit të EUROBORIT 01 ose në faqen në vazhdim dhe nëse nuk arrin, me anë të ndonjë mënyre publikimi të zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Nëse një përqindje e tillë nuk publikohet në këtë mënyrë, Banka do t’i kërkojë zyrave kryesore të Eurozonës të 4 Bankave të mëdha në Eurozonë, të zgjedhur nga Banka, të kuotojë përqindjen në të cilën depozitat e euros për një shumë të krahasueshme ofrohen nga secili prej tyre, për afërsisht në orën 11 sipas orës së Brukselit në datën e rivendosur sipas Bankave të mëparshme në tregun kombëtar të Eurozonës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen së paku 2 kuotime, përqindja për këtë datë të rivendosur do të jetë kuptimi aritmetik i kuotimeve.

Nëse sigurohen më pak se 2 kuotime siç kërkohet, përqindja për këtë datë të rivendosur do të jetë kuptimi aritmetik i përqindjeve të kuotuar nga bankat kryesore në Eurozonë të zgjedhura nga Banka pikërisht në orën 11.00 sipas orës së Brukselit në ditën, e cila bie dy ditë-pune pas datës së rivendosur për huatë në euro për një shumë të krahasueshme sipas bankave kryesore europiane për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

2. Për qëllimet e përcaktimeve të mësipërme:

i) të gjitha përqindjet që rezultojnë nga përllogaritjet që i referohen këtij skeduli do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme në pikën më të afërt të përqindjes të qindit dhe mijtit me gjysmat që do të rrumbullakosen.

ii) Banka do ta informojë Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra nga Banka.

iii) Nëse ndonjë nga kushtet e mësipërme, nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara nën patronazhin e Federatës Europiane të Bankave, Bankës Ndërkombëtare të Këmbimit, Banka me anë të njoftimit të Huamarrësit mund ta ndryshojë kushtin për ta sjellë atë në përputhje me kushtet e tjera.

SKEDULI C

C.1 Certifikata nga Huamarrësi

Drejtuar: Bankës Europiane të Investimeve

Nga: KESH

Data

Të nderuar zotërinj,

Subjekti: Kontrata financiare ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve dhe KESH e datës 29 shtator 2004 (që këtu e më poshtë do të referohet si “Kontratë financiare”)

Termat e përcaktuara në kontratën financiare kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë letër.

Për qëllimet e nenit 1.04 të kontratës financiare në këtu e më poshtë certifikojmë si më poshtë:

i) Asnjë garanci e tipit që ndalohet sipas nenit 7.02 nuk është krijuar ose ekziston;

ii) Asnjë rast i përmendur në nenin 10.01 nuk ka ndodhur ose vazhdon të mos zhdëmtojë;

iii) Për sa ne jemi të vetëdijshëm, kemi bërë kontrollin e pagesave, asnjë proces gjyqësor, arbitrazh ose procedime rregulluese apo investigimet, për të cilat procesi që na është shërbyer në ose ndonjë prej ndihmësve tanë janë pranuar dhe të cilat nëse do të përcaktoheshin anasjelltas mund të kishin një efekt material të kundërt me mundësinë tonë për të përmbushur detyrimet tona sipas kontratës financiare;

iv) Që ne kemi fonde të mjaftueshme për të siguruar përfundimin në kohë të projektit në përputhje me skedulin A1 të kontratës;

v) Shuma e kështit no. Të kërkuar nga Banka Europiane e Investimeve shoqërohet nga një kërkesë proporcionale sipas huasë BERZH;

vi) Duke ndjekur tërheqjen e kështit përkatës shuma agregate e kredisë të tërhequr nuk do t'i kalojë shpenzimet e grumbulluara të financuara nga Banka dhe që kanë ndodhur ose që janë angazhuar kontraktualisht nga Huamarrësi në përputhje me projektin me anën e shpenzimeve kualifikuese;

vii) Nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje materiale që të ndikojë.

Konvertimi i kështit nga i ndryshueshëm në fiks

Për të gjitha kështet e ndryshueshme VSFR aplikohen kushtet e mëposhtme:

A. Përcaktimet

Në këtë skedul:

Propozim konvertimi do të thotë një propozim të bërë nga Banka sipas paragrafit B.

Interes konvertimi do të thotë konvertimi i kështit, ose pjesë, nga i ndryshueshëm në fiks ose me normë interesi të rishikueshme për termat e saj të mbetur.

Data e konvertimit të interesit nënkupton datën e treguar të interesit në një kërkesë konvertimi të interesit, duke qenë një ditë tremujori që bie jo më pak se 4 vjet ose, në rastin e një kështi me ripagesë në një kësht, jo më pak se tre vjet para datës së maturimit.

Kërkesë për konvertim interesi ose kërkesë do të thotë një njoftim me shkrim nga Huamarrësi, dorëzuar së paku 75 ditë përpara një date të konvertimit të interesit, duke i kërkuar Bankës që t'i paraqes atij një propozim konvertimi për të gjithë kështin, ose për një shumë të specifikuar të kështit të tillë që, menjëherë pas konvertimit, shuma e konvertuar dhe çdo shumë tjetër e pakonvertuar do të jetë së paku 10 milionë euro ose ekuivalent. Kërkesa do të konfirmojë datën e konvertimit të interesit dhe të specifikojë datat e pagesave gjashtëmujore ose vjetore.

B. Mekanikat e konvertimit

Menjëherë pas marrjes së kërkesës së konvertimit, dhe kur e sheh të përshtatshme, dhe pas konsultimit të mëparshëm me Huamarrësin, dhe subjekt i disponibilitetit të Bankës do të në çdo ditë pune të Luksemburgut në intervalin midis 60 dhe 30 ditësh para datës së konvertimit të interesit të përcaktuar në kërkesë, deri në datën që Huamarrësi e pranon t'i dorëzojë Huamarrësit një propozim (Një propozim konvertimi) duke theksuar:

i) përqindjen e interesit që do të aplikohet për kështin, ose për pjesën e treguar në kërkesë, duke qenë një interes fiks për monedhën dhe periudhën përkatëse; dhe

ii) që përqindja fikse do të aplikohet që nga data përkatëse e konvertimit të interesit, interes që paguhet çdo gjashtëmujor ose, siç mund të jetë rasti, vjetor për borxhet në datat e pagesave të përcaktuara.

Huamarrësi mund të pranojë një propozim konvertimi deri në orën 17h 00 të Luksemburgut në ditën e marrjes.

Vetëm nëse Banka nuk arrin të dorëzojë në kohë propozimet e konvertimit në përgjigje të një kërkesë, mundet që Huamarrësi mund të bëjë një kërkesë tjetër. Çdo kërkesë tjetër do të jetë sipas datës së fundit të konvertimit të interesit.

Çdo amendament për kontratën i kërkuar nga Banka në lidhje me këtë do të bëhet efektive nga një marrëveshje ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit që do të konkludohet jo më vonë se 15 ditë para datës relevante të konvertimit të interesit.

C. Efektet e konvertimit

Në shkallën që Huamarrësi pranon një propozim konvertimi, Huamarrësi do të paguajë interesin e rritur në datën e konvertimit të interesit dhe datat e pagesës të përcaktuara që rrjedhin prej tyre.

Përpara datës konvertuese të interesit, kushtet e kontratës që kanë lidhje me kështet VSFR do të aplikohen për të gjithë kështin. Që nga data e konvertimit të interesit, kushtet që kanë lidhje me normën fikse të kështit do të aplikohen për të gjithë ose siç mund të paraqitet rasti, për pjesën e konvertuar të kështit, dhe kushtet e aplikueshme më parë do të aplikohen për llogaritjen.

E. Mosplotësimi i konvertimit të interesit

Në rastin kur Huamarrësi nuk e pranon një propozim konvertimi, ose në rast se palët nuk arrijnë të bëjnë një amendament të kërkuar nga Banka sipas paragrafit B, konvertimi i interesit nuk do të ndodhë dhe interesi do të paguhet në përputhje me nenin 3.01B.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 10.1.2005

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë